 M. PETTA, *Identificazione di codici greci elencati in una lista del secolo XVII esistenti nel Monastero basiliano di Mezzojuso*, in *Sonderdruck aus den Akten des XI internationalen Byzantinisten-Kongresses [München] 1958*. München 1960.
 M. PETTA, *Monaci cretesi in Sicilia nel secolo XVIII*, in «Bollettino della Badia Greca di Grottaferrata», vol. XV, 1961.
 B. LAVAGNINI, *Monaci cretesi a Mezzojuso, il Patriarca Atanasio II e la Sede di Ochrida*, in «Kretikà kronikà». 15 (1963).
 M. SCIAMBRA, *Indagini storiche sulla comunità greco-albanese di Palermo*, Grottaferrata 1963.
 A. DI MACCIO, *Nuovi contributi alla storia di Mezzojuso* [Tesi di laurea non pubblicata], Università degli Studi Di Palermo, Facoltà di Lettere, Anno Accademico 1963-1964.
 G. A. RIZZO, *Centri culturali degli Italo-Albanesi di Sicilia dalle origini ai nostri giorni* [Tesi di laurea non pubblicata], Università degli studi di Palermo, Facoltà di Magistero, Anno Accademico 1964-1965.
 E. MIONI, *Catalogo dei manoscritti greci esistenti nelle biblioteche italiane*. Vol. I, Roma 1964.
 D. COMO, *Italogreci ed Italoalbanesi*, in «Oriente Cristiano», 8, (1968).
 C. BISULCA, *Il Casale dei greci di Mezzojuso. 1450-1540*, Palermo 1970.
 ANNUARIO delle biblioteche italiane, Vol. II, Roma 1971.
 F. MASI, *Il Monastero basiliano di Santa Maria di tutte le Grazie di Mezzojuso* [Tesi di laurea non pubblicata], Università degli studi di Palermo, Facoltà di Lettere e Filosofia, Anno Accademico 1971-1972.
 H. BRESCH, *Pour une histoire des Albanais en Sicile XIV-XV siècles*, in «Archivio Storico Siciliano» 68 (1972).
 Il CARDINALE BESSARIONE nel V Centenario della morte (1472-1972), Conferenze di Studio, 7-8 nov. 1972, Roma 1974.
 I. GATTUSO, *Le istituzioni religiose di Mezzojuso*, Palermo 1975.
 V. PERI, *Chiesa romana e «rito greco»*, G. A. Santoro e la Congregazione dei Greci (1566-1596), Brescia 1975.
 I. GATTUSO, *Un mazzolino di giorni*, Agrigento-Palermo 1977.
 I. GATTUSO, *Due campanili sotto la Brigna*, Agrigento-Palermo 1978.
 V. PERI, *Culto e pietà popolare degli Albanesi d'Italia prima della riforma tridentina*, in «Oriente Cristiano» 3 (1980).
 D. COMO, *Una diocesi della Chiesa italo-albanese. L'Eparchia di Piana degli Albanesi*, Palermo 1981.
 V. PERI, *I metropolitani orientali di Agrigento. La loro giurisdizione in Italia nel XVI secolo, in Bisanzio e l'Italia. Raccolta di studi in memoria di A. Pertusi*, Milano 1982.
 M. SCADUTO, *Il Monachismo basiliano nella Sicilia medievale, Rinascita e decadenza sec. XI-XIV*, Roma 1982.
 V. VON FALKENHAUSEN, *I Bizantini in Italia*, Milano 1982.
 V. PERI, *Il concilio di Firenze: un appuntamento ecclesiale mancato*, in «Il Veltro» 27 (1983).
 A. FYRIGOS (a cura di), *Catalogo cronologico degli alunni e dei convittori del Pontificio Collegio Greco in Roma (1576-1640)*, in *Il Collegio Greco di Roma. Ricerche sugli alunni, la direzione, l'attività*, Pontificio Collegio Greco di S. Atanasio, Roma 1983.
 V. PERI, *La pace da ristabilire tra la Chiesa Greca e la Chiesa Romana nell'ideale unionistico di p. Giorgio Guzzetta*, in «Oriente Cristiano» 2-3 (1985).
 V. PERI, *Studio introduttivo a P. P. RODOTÀ, Dell'origine progresso, e stato presente del rito greco in Italia osservato dai greci, monaci basiliani, e albanesi libri tre scritti da Pietro Pompilio Rodotà professore di lingua greca nella Biblioteca Vaticana*, vol. I., r.a. dell'edizione di Roma, 1758, Cosenza 1986.
 I. ZUZEC, *Le «ecclesiae sui iuris» nella revisione del diritto canonico*, in R. LAUTOURELLE (a cura di), *Vaticano II: bilancio e prospettive venticinque anni dopo (1962-1987)*, Vol. II, Assisi 1987.
 V. PERI, *Presenza storica ed identità culturale degli Arberëshë*, in P. DE LEO (a cura di), *Minoranze etniche in Calabria e in Basilicata*, Cava dei Tirreni 1988.
 RACCOLTE librerie degli Albanesi in Sicilia. Mostra bibliografico-documentaria in occasione del V centenario della fondazione di Piana degli Albanesi, Palermo 1988.
 G. M. LO BELLO, *La Confraternita di Santa Maria di tutte le Grazie di Mezzojuso* [Tesi di laurea non pubblicata], Università degli Studi di Palermo, Facoltà di Lettere e Filosofia, Anno Accademico 1989-1990.
 A. ORNELLA, S. BIGATTON, P. FIGINI (a cura di), *Annuario delle biblioteche ecclesiastiche italiane*, 1990, Milano 1990.
 G. M. GROCE, *La Badia Greca di Grottaferrata e la Rivista «Roma e l'Oriente»*, Città del Vaticano 1990.
 ARTE sacra a Mezzojuso. Catalogo a cura di Maria Concetta Di Natale. Chiesa di S. Maria di tutte le grazie, 22 dicembre 1990-27 gennaio 1991. Mezzojuso 1991.
 T. FEDERICI, *La Scrittura rivela - l'Icona manifesta*, in «Oriente Cristiano» 3-4 (1993).
 N. FIGLIA, *Il codice chieutino*, edizione critica e concordanza a cura di M. Mandalà, Palermo 1995.
 P. DI MARCO, *Icone Arte e Fede, Mezzojuso*, Bagheria 1996.
 DI MARCO P. (coord.), *Mezzojuso - Territorio, storia, arte, tradizioni*, Mezzojuso, 1997.

- CANTI bizantini di Mezzojuso, a cura di Girolamo Garofalo, Palermo 2001.
 C. FREGA, *Madre Macrina Raparelli, fondatrice della Congregazione Suore Basiliene «Figlie di S. Macrina»*, Mezzojuso 2001.
 N. CHETTA, *Tesoro di Notizie su de' Macedoni*, Introduzione di M. Mandalà, trascrizione di G. Fucarino, Palermo-Contessa Entellina 2002 [1777].
 A. PERNICIARO, P. DI MARCO (a cura di), *Patrimonio librario ed iconografico*, Mezzojuso, 2002.
 A. PERNICIARO, *Il patrimonio librario di Mezzojuso, in Cinque secoli di cultura albanese in Sicilia*. Atti del XXVIII Congresso internazionale di studi albanesi. Palermo 2003.
 P. DI MARCO, *La Chiesa bizantina di Sicilia, in Cinque secoli di cultura albanese in Sicilia*. Atti del XXVIII Congresso internazionale di studi albanesi, Palermo 2003.
 M. MANDALÀ, *Nicolò Chetta. Nel bicentenario (1803-2003)*, Palermo 2003.
 I. GATTUSO, *Opere*, I - II - III vol., a cura di M. Mandalà, P. Di Marco, P. Di Miceli, Cosenza 2003.
 S. PARENTI - E. VELKOVSKA, *Mille anni di «rito greco» alle porte di Roma*, Monastero Esarchico Grottaferrata 2004.
 G. PATTACKAL, *La Congregazione Suore basiliene* [Tesi di laurea non pubblicata], Università degli Studi di Palermo, Facoltà di Scienze della Formazione, Anno Accademico 2003-2004.
 P. DI MARCO, *Mezzojuso, la Chiesa bizantina e la comunità arbëreshe di Sicilia*, in P. DI MARCO, A. MUSCO (a cura di), *Aspetti della Cultura bizantina ed albanese in Sicilia*, Palermo 2005.
 N. DRAGOTTA, *Spiegazione della messa di S. Giovanni Crisostomo - Senso letterale, mistico, storico e dogmatico*, a cura di A. e P. Perniciaro, Mezzojuso 2006.

della comunità monastica di Mezzojuso risultò la più saggia oltre che la più opportuna. Da notare che ciò avvenne su precisa indicazione dei Cardinali di quella Congregazione, a dimostrazione del favorevole concetto che essi avevano del monastero e della maturità spirituale raggiunta in esso.

Si possono solo immaginare le sensazioni provate dal fondatore (ormai scomparso) e dalle comunità arbëreshe di Sicilia quando l'abate del monastero, Nilo Catalano, elevato ad arcivescovo di Durazzo e Vicario Apostolico, con Filoteo Zassi, il 10 maggio 1663 arrivarono in Cimarra. Il lavoro che li aspettava era tra i più difficili. Trovarono: desolazione, miseria, poco o niente formazione culturale e insufficiente formazione cristiana. Per i primi sei mesi a Drimades misero su una scuola frequentata da 80 giovani, poi passarono in Cimarra e poi ancora a Vuno. Venuto meno Mons. Nilo Catalano, prese il suo posto P. Filoteo Zassi, coadiuvato da P. Callinico Granà (ambedue nativi di Mezzojuso); più tardi operarono i due jeromonaci Basilio Matranga e Giuseppe Schirò (ambedue di Piana degli Albanesi) insigniti della dignità arcivescovile.

Di questo periodo è una relazione del 7 agosto 1732 inviata dalla Cimarra che illustra la situazione della missione firmata (e perciò rappresenta una sintesi meravigliosa) da Don Lorenzo Guzzetta dell'Oratorio di S. Filippo Neri Missionario Apostolico di Cimarra, D. Filippo Matranga Ciulla dell'ordine di S. Basilio Missionario Apostolico in Cimarra, D. Giorgio Schirò del Monastero di S. Basilio Vicario Apostolico.

L'attività missionaria svolta in Albania da questi degni figli di S. Basilio, che tanto onorarono il monastero di Mezzojuso e le comunità arbëreshë dove nacquero, viene ampiamente descritta, basandosi sulla base di numerosi documenti esistenti negli archivi di Propaganda e altrove, da P. Nilo Borgia.⁵²

In Sicilia, le comunità arbëreshe guardavano al loro monastero con orgoglio e venerazione, considerandolo un cenacolo di pietà e di studio, grazie al ruolo delle scuole in esso attivate. Tutti i monaci dovevano possedere una buona cultura greca, almeno religiosa. Nel Monastero viveva l'uso della lingua albanese. Non lo possiamo affermare con sicurezza per i latini perché anche quelli che andarono in Albania come missionari operavano nella Chimara, regione notoriamente bilingue, dove anche il greco era correntemente usato.⁵³ Si può, quindi, supporre che alcuni parlassero albanese e altri il greco.⁵⁴

Eloquente dimostrazione è la figura dell'abate Don Nilo Catalano di Castania (Messina). Pur latino di nascita, diviene monaco a 22 anni a Grottaferrata (16 marzo 1659), viene a Mezzojuso dove apprende alla perfezione la lingua albanese, la lingua e letteratura greca oltre che quella italiana. (1678-1681).

Quando ai primi del Settecento si profilò la minaccia di inaridire la vitalità⁵⁵ del Monastero con il proibire il diretto reclutamento presso gli arbëreshe, vi fu una generale levata di scudi a sua difesa e un susseguirsi di suppliche e di memoriali alla Santa Sede da tutte le comunità arbëreshe.

Un esempio fra tutti: il memoriale del 15 ottobre 1703 della «Università della terra della Chiana Albanese» con il quale si supplica Clemente XI di non permettere mai che ad essi *albanensis nationis superstites propagines* vengano a mancare uomini probi e alunni bravi, esperti nelle lettere greche *pro servanda rituum nostrorum puritate*. E dove meglio, essi dicono,

1. Questo saggio riproduce il testo di una relazione presentata al Convegno storico «Padre Giorgio Guzzetta e la cultura del suo tempo», Palermo, Chiesa di S. Maria dell'Ammiraglio (Martorana), 23 marzo 2007. L'articolo è già stato pubblicato sul sito www.jemi.it e su «Mediaeval Sophia». Studi e ricerche sui saperi medievali E-Review semestrale dell'Officina di Studi Medievali n. 2 (Luglio-Dicembre 2007). E sul sito www.dimarcoezojuso.it curato dallo stesso Di Marco Pietro.

2 Il primo datato: Palermo, maggio 1131. Cfr. Cod. Vaticanus Latinus 8201 (*Bolle e diplomati di ogni genere latini e greci per l'archimandritato di Messina dell'ordine di S. Basilio dal sec. XI all'anno 1536*), fol. 128rv; S. CUSA, *I diplomati greci ed arabi di Sicilia pubblicati nel testo originale, tradotti ed illustrati*, Palermo 1868-1882, vol. I, p. 292, trad. lat. in *Vat. Lat. cit.*, fol. 269 e R. PIRRI, *Sicilia Sacra disquisitionibus et notitiis illustrata*, in Burmanni, *Thesaurus antiquitatum et historiarum Siciliae*, 14 tt., Lugduni Batavorum 1723, tt. II e III, pp. 1148-1149; E. CASPAR, *Roger II und die Gründung der Normannisch-sizilischen Monarchie*, Innsbruck 1904, Reg. n. 69, p. 507; B. MONTFAUCON, *Palaeographia graeca*, Parisiis 1708, p. 387; F. TRINCHERA, *Syllabus graecarum membranarum*, Napoli 1865, p. 138, dove però la data 6638 (= 1130) va spostata di un anno, perché nel maggio 1130 Ruggero II non era ancora re come si dice nel diploma. Cfr. in proposito K. A. KEHR, *Die Urkunden der normannisch-sizilischen Könige*, Innsbruck 1902, p. 50; E. CASPAR, *Roger II...*, cit., Reg. n. 68, p. 472.

Il secondo datato: febbraio 1133. Cfr. testo in *Vat. Lat.* 8201, fol. 56r e 130 (greco); trad. lat. ib. fol. 271; R. PIRRI, *Sicilia Sacra...*, cit., p. 1151 ss.; O. GAETANI, *Vitae sanctorum sicularum*, Palermo 1657, t. I, p. 5; E. CASPAR, *Roger II...*, cit., Reg. n. 95, p. 523 (erroneamente sposta la data, seguendo il Pirri al 1134).

3 L'elezione degli egumeni degli altri monasteri, cioè, doveva ricevere la conferma dell'archimandrita, e l'elezione di questi doveva avere, naturalmente, il consenso della corte. Sulla storia del monachismo dal XI al XIV secolo, fondamentale è lo studio di M. SCADUTO, *Il monachismo basiliano nella Sicilia medievale, Rinascita e decadenza, sec. XI-XIV*, Roma 1982.

4 G. GENTILE, *Studi sul Rinascimento*, Firenze 1936, p. 46.

5 Barlaam (1290-1350), ricevette da giovane un'accurata educazione in S. Elia di Galatari (monastero della Calabria bizantina), grecista e filosofo, oltre ad essere conosciuto per essere stato maestro di greco del Petrarca, intervenne nella discussione sulla questione ascetica detta «palamitica» sorta a Costantinopoli e a Salonico con il suo interlocutore e diretto avversario Gregorio Palamas.

6 Giovanni Bessarione, nato a Trebisonda il 2 gennaio 1403, entra in monastero a Costantinopoli nel 1423 e viene ordinato sacerdote nel 1431. Studia a Mistrà presso Sparta avendo come maestro Gemisto Pletone. Egumeno a Costantinopoli nel 1433, viene eletto nel 1437 Metropolita di Nicea. Svolge un ruolo determinante nel Concilio di Firenze del 1439. Cardinale in quello stesso anno, Abate Commendatario di Grottaferrata nel 1449, muore a Ravenna nel 1472 e viene sepolto nella Chiesa dei Santi XII Apostoli a Roma con l'epigrafe «Latinorum Graecissimus, Graecorum Latinissimus». Sull'opera e la vita del Bessarione, cfr. L. MOHLER, *Kardinal Bessarion als theologe, humanist und Staatsmann*, 3 voll., Paderborn 1923-1942, in particolare vol. I, pp. 248-257; A. GUILLOU, *Aspetti della civiltà bizantina in Italia*, Bari 1976, pp. 401-411; LAURENT M. H., GUILLOU A., *Le «Liber visitationis» d'Athanasios Chalchepoulos*, Città del Vaticano 1960, passim. Il Cardinale Bessarione nel V centenario della morte (1472-1972), Roma 1974 (Volume estratto dalla Miscellanea Francescana, rivista di scienze teologiche e di studi francescani, t. 73 [1973], F. III-IV, pp. 249-386).

7 «Il monastero di Grottaferrata è stato fondato nel 1004 - quasi 500 anni prima dell'esodo albanese in Italia - dal santo monaco Nilo di Rossano su un terreno messoggi a disposizione dal conte Gregorio di Tuscolo». Cfr. G. GIOVANNELLI, *S. Nilo di Rossano fondatore e patrono di Grottaferrata*, Badia Greca di Grottaferrata 1966, pp. 113-114.

8 Nel novembre del 1446 riuni in Capitolo nella Basilica dei SS. Apostoli in Roma gli abati dei monasteri della Sicilia, Calabria e Puglia, le cui deliberazioni furono approvate da Eugenio IV il 14 dicembre 1446. Gli Statuti del Capitolo si trovano nel Ms. *Vat. Lat.* 6204, ff. 154-157, dal titolo *Costituzioni del Capitolo Generale della Religione di S. Basilio celebrato in Roma nel mese di novembre 1446 sotto Eugenio IV*. Il testo è stato pubblicato da R. LOERNERT, in «Bollettino della Badia di Grottaferrata», 1 (1947), pp. 179-184.

A do të lindë një tjetër diplomat si Ismail Qemali

Nga Vilhelme Vrana Haxhiraj - Vlore

Në fundshek. e XIX, pas luftës Ruso-turke, Traktati i Sh.Stefanit (1878) Kong. i Berlinit, e bënë kurban Shqipërinë, sikur ishte humbësja e shteteve ndërluftuese. Kjo padrejtësi i revoltoi shqiptarët me banim jashtë vendit, që në vazhdimësi të aktivitetit, krijuan shoqata atdhetare kulturore- patriotike. Kjo lëvizje e nisur herët, u quajt *Rilindja Kombëtare*. Disa syresh, me poste të larta në Perandorinë Osmane, i shfrytëzuan këto poste për përgatitjen e terrenit për Pavarësinë kombëtare.

*Zanafilla e Pavarësisë ishte Lidhja e Prizrenit me atributin e Qeverisë së Përkorme, i pari formacion politik kombëtar.

*Raujtja e kulturës, gjuhës dhe traditës, jo vetëm si dëshmi, por si faktorë vendimtarë të autoktonisë së kombit, që i mençuri Ismail Qemal Bej Vlora i përdori me diplomaci, përmes së cilës shfrytëzoi *dobësinë e P.Osmane*, për të bërë gjënë e duhur.

*Plaku *flok'argjend, me kulturë të gjërë, njohës i disa gjuhëve*, për interesa të kombit shfrytëzoi *karrierën politike*, si dhe *bashkëjetesën e tri besimeve fetare*, gjë që ka ruajtur etninë dhe vëllazërimin e shqiptarëve.

*Me maturinë e tij, *evitoi përçarjet mes shqiptarëve* dhe vuri në plan të parë çështjen madhore, kombin.

*Si *Gubernur i Varnës, priti Perandorin Franc Jozefi*, të cilit i parashtrij gjendjen e Shqipërisë dhe kërkesat e tij për Pavarësi.



*U zgjodh *Kryetar i Komisionit N/kombëtar* në Danub, post që e përdori në favor të kombit.

*Më vonë *Kryetar i Dhomës së Deputetëve në Parlamentin turk*, që i shfrytëzoi për Pavarësinë.

*Analiza *social-politike* e I. Qemalit mbi gjendjen e Perandorisë në Egjipt, mbi çështjen e Kretës dhe luftën ruso-turke, ku Turqia humbi, u bë një përvojë paraprake për shpalljen e Pavarësinë Kombëtare.

*I. Qemali *refuzoi postin e Ministrit të Jashtëm e atij Shëtitës*, se dëmtonte çështjen shqiptare.

*Takimi me *rethet përparimtare, personalitetet politike e diplomatike të Evropës*, bënë të njohur problemin shqiptar në opinion botëror.

*Ndërsa ishte *Kryetar i Partisë liberale turke*, I. Qemali, ardhjen e turqëve të rinj e quan anarki të rëndë e të rrezikshme.

*Kur emërohet *Gubernur në Tripolitani*, ai nuhati rrezikun, kërkoi strehim politik në ambasadën angleze, e cila e nisi në Athinë. U mirëprit nga mbreti *Georg i I-rë i Greqisë dhe nga shqiptarët* me banim aty.

*Që aty nisi *fushatën diplomatike* nëpër oborret e Europës, i shtyrë nga shqiptarët e Australisë (në Athinë).

*Më parë shkoi në vende ku njihet çështja shqiptare, *Romë, Kalabri e Sicili*.

*Si diplomat i hollë, shfrytëzoi *mosmarrëveshjet Austri-Itali për influencën në Shqipëri*, e cila kishte dalje strategjike në Adriatik.

*Ai *zvogëloi dhe frenoi* disi përpjekjet për epërsinë ndaj Shqipërisë si të *Austrisë, Italisë, Greqisë e Serbisë*.

*Me shkathtësi, ai shfrytëzoi *situatat politike mes shteteve evropiane* dhe secilit në veçanti.

*I. Qemali *vlerësonte shtypin*, ndaj shkoi në Gjenevë, Bruksel.

*Pati *rëndësi të madhe takimi me Faik Konicën* për të reklamuar aktualitetin kombëtar në gazetën e tij "*Albania*", në gjuhën shqipe.

*Dalja e gazetës së I.Q "*Shpëtimi i Shqipërisë*", në gjuhë shqipe, greke dhe turke, ringjalli ndjenjen kombëtare te shqiptarët në botë.

*Në vizitën e tij në Londër për *vdekjen e mbretëreshës Viktoria të Anglisë*, ku u takua me personalitete të politikës botërore për interes kombëtare.

*Prej andej shkoi në Egjipt, ku kishte shumë shqiptarë. Aty nuhati *intrigën* e Mehmet Ali Pashës, i cili kishte hapur opinionin sikur P.e Lartë i kishte pranuar për hir të origjinës me sulltanin. Ai e përgënjeshtroi këtë lajm, por sulltani, për hesape të vjetra, e dënoi me vdekje në mungesë.

*Ai shfrytëzoi *bukur shkërrmoqjen e P. Osmane* që po kalonte çaste të vështira për shkak të kryengritjeve në Ballkan.

*I. Qemali *shfrytëzoi ndarjen e turqve të rinj* më 1908 në 2 grupe.

*Nga përvoja diplomatike dhe vizitat nëpër Europë, ai u *mështrua në 2 Fuqi të Mëdha: Austro-Hungari dhe Itali*, që për qëllimet e tyre, ishin kundër

pushtimit të Shqipërisë nga Greqia dhe Serbia.

*Puna me shtypin dhe bisedimet me lëvizjen përparimtare në Athinë, Romë, Vjenë, Paris, Londër, Kajro, Bukuresht me shqiptarët jashtë vendit, ndryshuan opinionin e Europës, që na konsideronin pa ideale kombëtare.

*Pas Memorandumit të Gërçës, hartuar nga I. Qemali e H. Prishtina nisën kryengritjet e përgjithshme 1909-1911.

*I. Qemalit si largpamës dhe vazhdues i Rilindasve, për realizimin e Pavarësisë kërkonte mbështetjen e *ndërkombëtarëve* për këto çështje:

1- *Kushtetut dhe Autonomi* administrative për popujt e ndryshëm të Perandorisë.

2- *Shqipëria të ketë 2-3 apo 4 vilajete* me krahina shqiptare.

3- *Hapja e shkollave shqipe* dhe botimi i librave shqip në trevat ku flitet shqip.

4- *Gjuhë zyrtare - shqipe*.

5- *Të krijohej policia, postë telegrafa, marrëdhënie diplomatike me Perëndimin dhe fqinjësia e mirë*.

6- *Kërkesa për autonomi dhe jo Pavarësi*, përputhej me kushtet ekonomike të vendit.

7- Ai, si diplomat i hollë, kërkoi *organizimin e një shteti evropian*, se Shqipëria në shekuj ka qënë lidhur ngushtë me Perëndimin.

Jemi në prag të 112 vjetorit të shpalljes së Pavarësisë, e nisur nga situata ndërpolitike shqiptare, me të drejtë pyes: "*A do të lindë në Shqipëri një tjetër diplomat si Ismail Qemali, i cili në kushte pushtimi shekullor, arriti ta bënte Shqipërinë të njohur si shtet të pavarur, fal finesës së tij diplomatike? Shqipërisë s'i mungojnë mendjemprehtët, por duhet të lenë pas egon, hakmarrjen e t'i kthehen paqes, vëllazërimin e mirësisë!*"

Poet dhe filozof i misticizmit shqiptar



Nga FERID VOKOPOLA

Ferid Vokopola lindi në Vokopolë të Beratit më 18 gusht 1887. Atdhetar dhe njëri nga pjesëmarrësit e Kuvendit Kombëtar të Vlorës. Në vitin 1920 ishte ndër organizatorët e Kongresit të Lushnjës.

Ai iu përkushtua fesë dhe ishte ndër themeluesit e Medresesë së Tiranës dhe bashkëpunëtor i njohur i shtypit laik e fetar. Autor i veprës "Gjëmimi i Tomorrit", përmbledhjes me vjersha "Symbyllazi me ëndërrime" dhe vëllimit me poezi "Fluturimet e shpirtit." Ferid Vokopola përktheu Kur'anin dhe la në dorëshkrim Kalendarin Osman. Në shtypin shqiptar të viteve 1920 - 30 ndriçoi pena e fuqishme e tij, si një prej figurave poliedrike të kohës. Studioi në Universitetin e Stambollit për drejtësi dhe ekonomi. Ai ishte politikan, ekonomist, teolog, poet, filozof dhe eseist. Më 28 nëntor 1912, Ferid Vokopola firmosi dokumentin e Shpalljes së Pavarësisë si delegat i Vlorës. Më 1914 bëri pjesë në ekipin e Ministrisë së Buqësisë të Qeverisë së Durrësit. Pikërisht në këtë kohë ai hartoi kriterin e përkthimit dhe të komentimit të Kur'anit. Ferid Vokopola, do të shkruante në 100 vjetorin e lindjes së Ismail Qemalit: "Ismail Qemali, si biri i vetëm i Shqipërisë, rrëmbeu Flamurin, doli në ballkon dhe e ngriti me dorën e vet, duke iu drejtuar popullit me fjalën e madhe patriotike, me të cilën i bëri të ditur Shqipërisë dhe Botës mbarë se në këtë çast vendimtar, nën rradhët e Mbretërive të Mëdha e të vogla shtoi dhe një shtet i ri, që populli i vetë ishte një nga trashëgimtarët më të vjetër të Ballkanit. Atë unë e njoha dhe e pashë në këto çaste vendimtare shumë më të ndryshuar se herë të tjera... Ishte më parë një Yll e tani një Diell i botës shqiptare; ishte më parë një Luftëtar i Lirisë, një shërbëtor besnik i Kombit e tani një shpëtimtar i Popullit."

Atdhetari i flaktë Ferid Vokopola në kujtimet e tij, lidhur me ato ditë të vështira të pragshpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, në gazetën "Përlindja e Shqypnjes", viti II, nr. 6-7 të dt. 30 janar e 1 shkurt 1914, shkruan: "... u nisëm përmes Myzeqesë në ato kohëra të këqija nga dimri i fortë e arritëm në Fier, ku takuam edhe Ismail Qemal beun me shokë. Ismail Qemal beu në zyrën telegrafike merrte shpjegime mbi situatën e okupacioneve dhe jepte këshilla mbi masat që duheshin e me padurim të mblidheshin delegatët shpejtësisht në Vlorë. Kur ishim në zyrën telegrafike më vjen një telegram mua nga nëna ime që ishte me plevit tepër të rëndë dhe Ismail beu më thotë: "Shko biri im në Berat, hallallosu me mëmën, ti marrësh uratën e pastaj hajde në Vlorë me delegatet e Bera-

tit. "Duke e digjuar, unë i thashë se jam nisur për Mëmën Shqipëri, e uratën kam me ja marrë kësaj. Ai më përgëzoi atënisht me një bravo, e cila i buroj nga zemra... dhe vuna re se sytë i kishte të lotueshëm. Nga Fieri u nisëm për Vlorë. Atje agallarët Sharra çelën shtëpinë e na pritën me bujari të madhe. Ndërkohë prisnin me padurim të vinnin delegatët e vëndeve të tjera." Dokumenti i Shpalljes së Pavarësisë u botua në gazetën "Përlindja e Shqypnjes", organ i Qeverisë së Përkohshme të Vlorës, edhe nën kujdesin e firmëtarit më të ri të Aktit të Shpalljes Pavarësisë (vetëm 25 vjeç) Ferid Bej Vokopola. Gjatë periudhës 1920-1928 u zgjodh deputet i Vlorës, kurse gjatë viteve 1928-1939 deputet i Beratit. Pikërisht në këtë kohë, në bashkëpunim me Sali Vuçiternin e të tjerë, ai bëhet një nga organizatorët kryesorë për themelimin e Komunitetit Mysliman Shqiptar dhe jep një kontribut të ndjeshëm për ngritjen e Medresesë së Përgjithshme të Tiranës.

Më 26.10.1927 deri më 10.5.1928 Ferid Vokopola mbuloi postin e Ministrit të Buqësisë në Qeverinë Shqiptare. Në Kongresin e Lushnjës, (21.1.1920) ai mbajti fjalën e hapjes dhe u zgjodh Sekretar.

I frymëzuar nga kjo ngjarje historike, ai shkroi himnin e Kongresit të Lushnjës. Poezia e këtij himni është një muzikalitet me tinguj melodioz. Më 1919 boton "Fluturimet e Shpirtit," në vitin 1920 botoi vëllimin me poezi "Symbyllazi me ëndërrimet", dhe në vitin 1942 botoi veprën poetike "Gjëmimet e Tomorrit."

Stili i tij ishte atraktiv, gjuha plot figura, metrika e respektuar. Figurat e përdorura në poezinë e tij kanë karakter simbolesh, gjithmonë brenda botës së madhe të emocioneve. Ai është përfaqësuesi më i shquar i misticizmit islam në Shqipëri, në gjysmën e parë të shekullit XX-të, dhe radhitet ndër persologët më të rëndësishëm shqiptarë. Poezia e poetit Ferid Vokopola është e udhëhequr tërësisht nga misticizmi dhe qëndron në tre përbërës kryesorë: Njeriu, Natyra dhe Zoti, ku mbi të gjitha qëndron Zoti. Në revistën të shquar të kohës "Zani i Naltë," poeti dhe filozofi i shquar Ferid Vokopola botoi poezinë "Përndimi i Shejh Shaban Tixhanisë," si dhuratë miqësore e gjurmuesve të tarikatisë Tixhani, duke i bërë himn vetë njeriut, që qëndron në thelb të doktrinës së tij filozofike dhe religjioze. Frymën e misticizmit islam e solli në vjershërimin poetik shqip Naim Frashëri, dhe e vazhdoi Ferid Vokopola.

Ai shprehej në vargjet poetike: "Fillonj me emnin e t' madhit Zot Që është bekues e Mëshirplotë."

Në fushën e legjislacionit Ferid Vokopola u shqua si një nga ligjëbërësit kryesorë të Parlamentit të viteve 1920-1930. Ai së bashku me deputetë të tjerë të besimit islam përgatitën dhe miratuan në Parlament, Kodin Civil të viteve 30-të të shek. XX, dhe që u vlerësua si hapi më i rëndësishëm për përparimin dhe zhvillimin e vendit. Me pushtimin e Shqipërisë nga Italia në 1939, Ferid Vokopola u tërhoq nga jeta politike dhe administrata shtetërore, duke i'u kushtuar krejtësisht aktivitetit fetar. Në këtë kohë, ai themeloi

në Tiranë organizatën fetare "Drita Hyjnore", që pati si organ të saj revistën "Njeriu", e cila doli rregullisht nga korriku 1942 deri në qershor 1944. Në këtë revistë ai botoi një pjesë të shkrimeve të tij, ku shquhen në mënyrë të veçantë poezitë e tij simbolike me theks filozofik.

Duke qënë njohës i mirë i mistikës islame, ai e përçon këtë frymë pothuajse në të gjitha poezitë e tij.

"Zani i Naltë" ishte një revistë letrare fetare që u publikua nga tetori 1923 deri në prill 1939, në të njëjtën kohë me "Udhën e s'vërtetës" dhe "Kultura Islame." Mirëpo, ndërsa "Udha e s'vërtetës" u publikua në Shkodër, "Zani i Naltë" që ishte botim i Komunitetit Mysliman Shqiptar doli në Tiranë. Nga Ferid Vokopola në të u pasqyruan dy të drejtat më të respektuara të njeriut. E drejta e pluralizmit kulturor, ku kulturat e ndryshme zhvillohen së bashku dhe e drejta e pavarësisë kulturore, ku një kulturë zhvillohet e vetme në hapësirën e saj. Pra, kultura e lindjes dhe ajo perëndimore u ngjizën në kulturën shqiptare, nëpërmjet inteligjencës krijuese të Ferid Vokopolës.

Në aspektin e vlerësimit teologjik dhe filozofik të moralit islam, ai u shpreh për çështje madhore dhe shkroi esetë filozofike "Problemi i Zotit dhe Djallit", "Verdikt i fatit" dhe "Moral dhe epshi i masave." Në këtë revistë më të shquarën e kohës, ai botoi dhe studimet e esetë në fushën e historisë së artit, si: "Kuptimi i artit dhe kufijtë e tij", "Shkrimtarët e Letërsisë Islamike në Shqipëri" e tjerë. Në korrik 1942, doli në Tiranë revista kulturore dhe fetare "Njeriu". Qysh në numrat e parë, kjo revistë periodike e përmuajshme e kishte të përcaktuar orientimin shpirtëror dhe kulturor të saj. Me përkthimin e vargjeve kur'anore dhe të mësimëve të Profetit dhe botimin e tyre në faqet e revistës "Njeriu", të edituar dhe drejtuar nga Ferid Vokopola, u kontribua në formimin e një pikëpamjeje bashkëkohore mbi moralin, filozofinë, edukimin, qytetërimin dhe besimin islam. Revista "Njeriu" ishte organ i Shoqatës "Drita Hyjnore" e themeluar nga Ferid Vokopola. Në përbajtjen e saj në gjejmë një gërshetim të teorisë me praktikën, me misticizmin si epiqendër të saj. Politika redaksionale e Ferid Vokopolës e përcaktoi këtë teori si: "Misticizmi me të gjithë karakteristikat e ngjashme të tij, është rruga e zakonshme e njohjes së të vërtetës. Ajo është boshti, i cili ka të përfshirë të gjithë luftën dhe përpjekjet në kuptimin, ndikimin, këmbënguljen dhe përhapjen e veprës së ndritur të mirëbërësisë. Në faqet e kësaj reviste Ferid Vokopola botoi edhe shkrime të Fan Nolit, Faik Konicës, Lasgush Poradecit, Mithat Frashërit dhe intelektualëve më të rinj si Suat Haxhit, Mustaf Greblleshit, Jup Kastratit etj. Revista doli në 27 numra dhe u mbyll në qershor 1944. Ferid Vokopola botoi dhe përkthime të pjeshme në revistën tjetër të kohës "Kultura Islame", ku bashkëpunoi ngushtësisht me figura të shquara të kulturës shqiptare si: Sherif Putra, Haki Sharofi, Sadik Bega e të tjerë. Edhe në fushën e përkthimeve nga osmanishtja, ai u shqua mbi të tjerë, duke prurë në shqip thesare të letërsisë dhe kulturës perse në veçanti dhe asaj

islame në përgjithësi. "Rubaij-jati" (Rubaijat) i poetit pers Omar Kajamit u botua për herë të parë më 1942 në Tiranë, veprë në vargje prej 139 faqesh i Hafiz Ali Korçës. Me kërkesë të tij, Ferid Vokopola shkroi parathënien e kësaj veprë fundamentale të kulturës perse, që vinte në shqip për herë të parë.

Ferid Vokopola, një nga zotëruesit e mirënjohur e më të përkryer të disa gjuhëve të huaja të lindjes dhe të perëndimit, në parathënien e këtij libri, vëren: "Shtatë shekuj fjeti në hirin e harresës edhe vepra e "Rubairave" të Omar Kajamit, pra, s'dihej të çmohej prej një bote fantastike e fanatike, realiteti i jetës, që ai poet e filozof i shquar, ishte munduar të shpjegonte në vargjet e bukura katrore." Ferid Vokopola nxiti dhe frymëzoi ngjizjen e kulturës islame në kulturën dhe inteligjencën krijuese shqiptare. Kongresi i Shoqatës "Drita Hyjnore" i mbajtur në mars 1920, shqyrtoi probleme të njohura të komunitetit islam shqiptar, por që nuk kishin marrë ende zgjidhje deri në atë kohë. Në vitet '20 ishte pjekur mendimi për të krijuar një shkollë të mesme fetare islame me fizionomi bashkëkohore. Ky kongres, ndryshe nga dy të parët, u morë edhe me sigurimin dhe mirëmbajtjen e objekteve fetare, ndërsa një komision i veçantë u morë me hartimin e raportit vlerësues për të ardhurat e vakëfeve.

Agjahl Lihohova, i dërguari i qeverisë dhe Ferid Vokopola - deputet, shpjeguan më pas reformat që duhej të kryeshin dhe rëndësinë e tyre. Idhtarë të kësaj ideje dhe iniciatorë të kësaj ndërmarrjeje u bënë personalitete të shquara të politikës shqiptare të atyre viteve. Me rënien e Kalifatit, ngrija e një shkollë të tillë shtrohej si një çështje emergjente. Grupi i iniciatorëve kryesorë përbëhej nga Haxhi Vehbi Dibra, senatori Sali Vuçiterni, intelektualët e shquar Ferid Vokopola dhe Qamil Bala. Medresea që do të ngrihej synonte të përgatiste klerikë të ditur, të pajisur me njohuri të larta fetare, filozofike e shkencore në përkatësi me arritjet e arsimit bashkëkohor. Në mesin e shumë studiuesve të Kur'anit në botë, ndër të parët që u morën me studimin e Kur'anit në mbarim të shekullit XIX dhe fillim të shekullit XX nga shqiptarët, ishin Ferid Vokopola, Hafiz Ali Korça dhe Haxhi Vehbi Dibra. Këta studiues, padyshim, bëjnë pjesë në bashkësinë e artë të studiuesve më të famshëm shqiptarë të Kur'anit, gjatë shekullit që lamë pas. Pushteti komunist e burgosi. Në qelinë e burgut nuk ra as në dëshpërim, as në pesimizëm. Në këtë kohë ai shpesh thoshte: "Unë nuk jam as pesimist dhe as optimist, por mundësisht." Dhe... ai kishte të drejtë, mbasi mundësia vjen vetëm me punë dhe përkushtim të inteligjencës krijuese në krijimin e vlerave të shoqërisë dhe të kombit. I bindur në pikëpamjet e tij islame, ai iu dedikua përkthimit të Kur'anit, punë të cilën ai e vazhdoi dhe e përfundoi për dhjetë vjet. Kur doli nga burgu, ai gjeti rreth e rrotull mjedisë të tjera, larg lirisë së fjalës e të mendimit, kundërshtarë deri në armiqësi ndaj fesë. Në këto rrethana, si zotërues i gjuhëve orientale, ai iu afrua Institutit të Historisë si bashkëpunëtor, duke i kaluar vitet e pleqërisë, si përkthyes i dokumenteve historike nga osmanishtja e vjetër.

(vazhdon ne faqen 20)

HAKMARRJA NË KODIN BARBARIÇINO TË SARDENJËS DHE NË KANUNIN E LEK DUKAGJINIT

Nga Prof. Lutfi ALIA, Siena - Itali

Hakmarrja e trajtuar në Kodin Barbariçin në trevën Barbaxhia të Sardenjës, ka ngjashmëri impresionante me aktin e hakmarrjes - gjakmarrjes në Kanunin e Lek Dukagjinit dhe në 25 kanunet e trevave të tjera shqiptare. Për të kuptuar çfarë përfaqëson Kodi Barbariçin, duhet bërë një vështrim historik, për të njohur origjinën e tij. Dihet se popullata sarde, për mijëra vite është sulmuar dhe është pushtuar nga popujt e tjerë të ardhur nga deti. Populli sard, ka përjetuar në shekuj kulturën autoktone Nuralgijike, por dhe atë të pushtuesve, si kulturën Fenike dhe Punike, më pas u ndikuan nga kulturat romake, bizantine, spanjolle dhe së fundi ato të mbretërive dhe të Republikës së Italisë.

Në historinë mijëvjeçare sarde, imponimi i kulturave të pushtuesve nuk e ka ndryshuar kulturën antike autoktone nuralgijike, e cila është transmetuar brez pas brezi, sidomos është ruajtur në zonat e thella të ishullit. Kultura e lashtë sarde shihet në Menhuret, në Domus e Janas që ishin varre paranuralgijike, ku jetonin Janas (Jana ishte figurë mitologjike sarde e njëjta si Zana iliro-arbërore); me shtatore gjigande të luftëtarëve sarde, ashtu si me figurat në bronz, që janë ndryshe nga ato në vendet e tjera të botës.

Popullata sarde, ishte në numër të vogël, andaj nuk mund të përballonte forcat e mëdha pushtuese, për pasojë në zonat bregdetare pranoi vendosjen e kolonive të push-tuesve, me të cilat krijoi raporte bashkëzistence paqësore dhe shkëmbimesh tregëtare, duke konsoliduar pakte Amistade (miqësie) dhe lidhje krushqie me popujt e adhur nga deti. Shkatërrimet më të mëdha ndodhën gjatë pushtimit nga romakët, të cilët depërtuan në zonat e thella duke grabitur dhe shkatërruar fshatra, duke marrë robër burra dhe gra që i kthyen në skllëvër. Pjesët e popullatës që nuk iu nënshtruan romakëve, u fshehën në zonat e thella si në luginën e Lanaitto, Tiskali, Gorroppu dhe në Supramonte. Në këto zona të thella jetuan të izoluar duke ruajtur identitetin sard. Në shekujt në vazhdim, koncepti i Sardenjës territoriale, mori format shtetërore, me ishullin e ndarë në entitete politike sovrane, të organizuara në katër mbretëritë Kallari, Torres, Gallura dhe Arborea. Ky organizim shtetëror shprehte kapacitetin e sardëve të jetonin të lirë nga dominimet e të huajve dhe të vetëdrejtoheshin nëpërmjet formave komplekse të sistemit me asambelën e gjyqtarëve sovranë të coronas de logu (kurora mbretërore e vendit), si dhe më ligjet e veta. Këto rregulla të lashta e frymëzuan Mariano IV D'Arborea (1317-1375), të hartojë Carta de Logu, që konsiderohet një ndër aktet më të hershme të sistemit juridik sard. Termi Logu, në latinisht logos - vendi, i përdorur dhe në gjuhë shqipe logu - vendi, si shprehet nga malësorët e veriut Logu i Bjeshekëve, pra në gjuhë sarde Carta de Logu, në shqip do të thotë Karta vendore. Në shkurt të vitit 1355, Pietro IV Aragon, mboldhi në Kallari parlamentin e parë të Sardenjës, ku u shpall kushtetuta, e cila i referohej Kartës të Logut të Arborea. [Meloni G, *Il Parlamento di Pietro IV d'Aragona (1355)*, in "Acta curiarum Regni Sardiniae", Cagliari, 1993, pp. 12 - 49].

Më 14 prill 1392, Eleonora d'Arborea (1340 - 1404) sovra e Arborea, shpalli Karta de Logu për mbretërinë e Arborea. Ky dokument legjislativ ishte shkruar në gjuhë sarde vulgare - Limba Sarda. Në vitin 1421, mbreti Alfonso V Aragon, në parlamentin e Kallarit konfirmoi zbatimin e Kartës të Logu të Eleonora d'Arborea, duke e shtrirë aplikimin e këtij akti në të gjithë Sardenjën. Karta de Logu e Eleonora d'Arborea, konsiderohet Kushtetutë e vërtetë sarde dhe mbeti në fuqi deri në vitin 1827 kur u zëvendësua me Kodin Feliciano (hartuar nga Karlo Felice). Karta e Logut përfshinë norma të kodeve civile dhe penale dhe një seri normash të veçantë të konsideruara kodi rural. [Solmi A, *Le costituzioni del primo parlamento sardo del 1355*, "Archivio storico sardo", VI, 1910, p. 193]. [Italo Birocchi e Antonello Mattone, *La Carta de Logu d'Arborea nella storia del diritto medievale e moderno*, edizione 2004, Collana Misura, p. 377].

Vite më pas, paralel me Karta e Logut, në trevën e Barbaxhia të Arborea, funksiononte Kodi Barabariçin, i cili sipas studuesve Pigiariu dhe Sirigu ishte kodi i përshtatur në kushtet lokale të disa aspekteve juridike dhe rregullash të Karta e Logut. Ky modifikim dhe transformim i Karta de Logu në Kodin Barbariçin është kryer gradualisht, në mënyrë të pandërprerë, duke i përshtatur jetës bujqësore - blegtorale të këtyre banorëve. Kodi Barbariçino ishte i pashkruar, por përmbanë disa norma të njëjta me Karta e Logut, të përshtatura në kushtet lokale, sidomos masat ndëshkimore dhe zbatimi i hakmarrjes për fyerjet dhe vrasjet, andaj shpesh emërtohet dhe Kodi i hakmarrjes. [Antonio Pigiariu, *La vendetta barbari-*

cina come ordinamento giuridico. Milano 1959, pp. 12 - 35] [Paola Sirigu, *Il Codice Barbaricino, La riflessione, Davide Zedda Edizione, 2007, 17 - 21*].

Kodi Barbariçin.

Banorët e trevës Barbaxhia të Arborea, kishin ligjet dhe rregullat e veta, që drejtonin organizimin e jetës, marrëdhëniet familjare e shoqërore në këtë zonë të thella, i njohuri Kodi Barbariçin, një kod i pashkruar. Emëri Barbariçin është me origjinë nga latinishtja - Barbarica - kodi barbarë. Ky kod rural me rregulla dhe norma etiko-morale të detyrueshme për të gjithë, bazohet në fjalën e dhënë nga kryefamiljari si garant, i cili jepte fjalën e nderit për zbatimin e pakteve të miqësisë (Amistade) dhe të respektit ndërmjet familjeve dhe komunitetit.

Kodi Barbariçino në trevën e Barbaxhia, ka mbetur i pandryshuar me rregullat dhe normat dhe pse ishin të pashkruara, njiheshin, riprodheshin besnikërisht brez pas brezi dhe të respektuara nga të gjithë banorët. Kodi Barbariçino mbijetoi më shekuj në formën e pashkruar, ashtu si Kanunet e Maleve shqiptare, ndërsa në vitet '50 të shekullit XX pedagogu i të drejtës penale Antonio Pigiariu, pasi i dëgjoi nga banorët të rrëfyera në gjuhën sarde (Limba Sarda), i transkriptoi, i përktheu në gjuhën italiane standarte dhe e sistemoi këtë kod në tre kapituj me 23 artikuj. Prof. Pigiariu, në vitet 1955 - 1969 botoi disa studime rreth përmbajtjes të këtij kodi dhe sidomos rreth hakmarrjes, për çka dhe e quajti Kodi i Hakmarrjes. Sipas Pigiariu, në trevën e Barbaxhia të Arborea, ky kod i pashkruar vepronte paralel me Karta e Logut. Sipas Pigiariu, Kodi Barbariçino në trevën e Barbaxhia përfaqëson një frakturë totale dhe definitive të banorëve me autoritetin e shtetit dhe shpreh jetën e izoluar mes maleve të barinjëve. Jeta e vështirë e barinjëve në Barbaxhia, për të plotësuar nevojat e familjeve, ishte në konflikt të përhershëm me natyrën dhe varfërinë dhe kushti i themelor për të mbijetuar në këtë mjedis, bariu duhej të ishte i fortë dhe burrë i ndershëm - uomo d'onore, në gjuhën sarde BALENTE, i cili e mbronte dinjitetin e tij, të familjes se tij dhe bëhej garant i fjalës së dhënë. Kush shkelte rregullat e kodifikuar ndëshkohej sipas tipit të shkeljes, ose të fyerjes të kryer nga individ, që konsideroheshin persona me pak vlera, andaj banorët i quanin *omine de paku gabbale*. Ky kod përmban rregulla dhe norma etiko-morale të marrëdhëniesve shoqërore dhe nuk është kod i banditizmit. [Antonio Pigiariu, *La vendetta barbaricina come ordinamento giuridico. Milano 1959, pp. 12 - 35*] [Antonio Pigiariu, *Il banditismo in Sardegna, il codice della vendetta barbaricino. Milano, Giuffrè edizione 1975, pp. 5 - 20*]

Kodi Barbariçino ishte pakti i aleancës ndërmjet familjeve, pakt me rregulla, me të drejta dhe me detyrime shoqërore, i transmetuar brez pas brezi, i pashkruar por i ruajtur në kujtesën e popullit, i cili ka transmetuar deri në ditët tona. Ky kod është shprehje e kulturës agro-blegtorale sarde, i vetmi burim i mbështetjes në popullatën e zonave të thella, i maturuar si formë e tutelës të identitetit të kulturës sarde, që nuk pranonte t'i nënshtronte kulturave të ardhura nga deti e në këtë mënyrë ruajti identitetin dhe origjinën historike, si thonin sardët: për t'u mbrojtur ndaj Continentales Istranzos, pra mbrohem nga popujt e huaj të ardhur nga kontinenti. Si kanë theksuar shumë studiues, mbrojtja ndaj të huajve dhe izolimi në brendësi të teritoreve sarde, kishte dikur organizimin familjar dhe shoqëror të bazuar në rregulla dhe norma, që grantonin mbrojtjen e identitetit sard, rregulla dhe norma etiko - morale të ngjashme me Kanunin e Lek Dukagjinit.

Kodi Barbariçino, përmban rregulla dhe vlera, mbi bazën e të cilave shquhet nderi i burrit - uomo d'onore, në gjuhën sarde BALENTE. Një burrë Balente nuk fyen dhe nuk mund të pësojë fyerje, sepse kur fyhet është i detyruar të përgjigjet me të njëjtën mënyrë, duke e vënë në vend nderin e tij dhe të familjes, pra duhet të hakmerret për fyerjen. Figura e Balente - burri që mbron nderin etj, shpreh një shoqëri të fortë me rregulla, ku vlen dinjiteti dhe krenaria e burrit dhe pikërisht këto vlera janë shtylla qëndrore ku mbështet kjo kulturë antike mijëvjeçare. [Solmi A, *Sulla "Carta de Logu" Cagliari, in Studi giuridici in onore di Carlo Fadda, Piero, Napoli, 1916, vol. I, p. 182*].

Rregullat e pashkruara në Kodin Barbariçino, përcaktojnë kufij të saktë për kryerjen e hakmarrjes, e cila nuk mund të kryhet me vetëgjyqësi nga individ i fyer, sepse sipas kodit, hakmarrja duhet të jetë proporcionale, e kujdesëshme dhe e kryer në mënyrë progresive nga burri me nder (Balente). Në artikuj të veçantë të këtij kodi shprehet karakteri parandalues, si p.sh theksohet: "Si no m'offenet, no l'offeno - se nuk më fyen, nuk të fyej", por nga ana tjetër thekso,

se ndaj fyerjes nuk mund të heshtet, detyrimisht fyese duhet të ndëshkohet si shprehet në këtë kod: Su sambene no esa ba - gjaku nuk është ujë dhe në vazhdim S'honore clamat vindicta - nderi kërkon hakmarrje. [Antonio Pigiariu, *La vendetta barbaricina come ordinamento giuridico. Milano 1959, pp. 12 - 35*].

Jeta e izoluar dhe mosbesimi ndaj popujve që vinin nga deti, vetorganizimi dhe vetadministrimi shoqëror dhe bujqësor - blegtoral në trevën malore të Barbaxhia, ndikuan të ruhet gjenia dhe kultura mijëvjeçare e këtyre banorëve, të cilët i kanë shmangur kontaminimet nga invazorët e huaj, kështu mbijetuan dhe garantuan vazhdimësinë në sajë të rregullave dhe normave me vlera morale të Kodit Barbariçino. Ky kod përmban vlera shoqërore që mësoshin gjatë jetës, prindërit ua mësonin fëmijëve e kështu transmetohej brez pas brezi, pa u ndryshuar, duke edukuar fëmijët për t'u ndergjegësuar si burrë nderi, burri Balente - burri me vlera. [Paola Sirigu, *Il Codice Barbaricino, La riflessione, Davide Zedda Edizione, 2007, 15 - 47*].



Barinjë në Barbaxhia, në fund të shekullit XIX.

Në trevën e Barbaxhia, jeton një komunitet i hershëm arbëresh, që ende flet gjuhën Arvareshu (Arbëreshe), të cilën linguistët sarde e konsiderojnë motër e gjuhës albaneze. Një grup familjesh malësorësh arbërore në fillimet e shekullit XVI, arrijtën në Sardenja me anijet e Andrea Doria dhe u vendosën në Barbaxhia, ku u impenjuan në aktivitetet bujqësore dhe sidomos në blegtori. Familjet arbërore dhe pse të huaja, u mirëpritën nga vendasit dhe u integruan në jetën e re të Barbaxhia, të organizuar me rregulla dhe norma etiko-morale të ngjashme me ato të vendeve të origjinës, të drejtuara nga Kanuni i Lek Dukagjinit. Gjuha arvareshu e herëshme ende ruan fjalë të gjuhës albaneze, të cilat i ka mbledhur studiuesi Salvatore Bovore Mele, disa prej tyre po i prezantoi në vazhdim, duke e shkruar së pari fjalët e shqipes aktuale, anash fjalët në arvareshu (në korsive), që fliten ende në Barbaxhia dhe fjalën në gjuhën italiane:

Anije - **anae** - nave
Baras - **barrasha** - equo, uguale
Bashkë - **bashka** - assieme
Bora - **borea** - neve
Dora - **dola** - mano
Guri - **gurdur** - pietra
Gjiri - **gjiria** - golfo
Kaloj - **cola** (kola) - passa
Këmba - **kama** - piede
I madh - **medha** - grande
Lumi - **lumina** - fiume
Mace - **macitu** - gatto
Mali - **malesha** - monte
Mendim - **miduine** - pensiero
Faleminderit - **fallegamindra** - grazie (indra - nderi)

Për rreth - **reti** - attorno
Rruga - **rucha** (ruka) - strada
Shumë - **e isumesia** - molto
Sulmoj - **shulonju** - scagliare
Sy - **seiu** - occhio
Zëri - **xirri** - voce etj, etj.

Para se të analizojmë ngjashmëritë e dukurive të hakmarrjes të Kodit Barbariçin me atë të Kanunit të Lek Dukagjinit, po prezantoj tekstin e Kodit që drejtonet jetën e banorëve në trevën malore të Barbaxhia - Sardenjë.

TEKSTI I KODIT BARBARIÇIN

Teksti i këtij kodi u prezantua nga Antonio PIGLIARU i cili e mblodhi sipas rrëfenjave gojore të banorëve të Barbaçia, i përktheu në italishten standarte dhe i dha formën e Kodit të sistemuar në 23 artikuj (nyje) të ndarë në tre kapituj: 1. Parime të përgjithshme; 2. Fyerjet; 3. Masa e hakmarrjes.

KAPITULLI I: PARIME TË PËRGJITHËSHME.

Artikulli 1.

Fyerja duhet të hakmerret.

Nuk është në nderin e burrit në se heq dorë nga detyrimi i hakmarrjes, me përjashtim të rasteve, kur ka pas dhënë prova burrnie në jetën e tij dhe heq dorë për motive morale të larta.

Artikulli 2.

Ligji hakmarrjes i detyron të gjithë ata, të cilët me çdo lloj titulli jetojnë dhe punojnë në komunitet.

Artikulli 3.

Titullari i detyrimit të hakmarrjes, si subjekt i ofendimit, si individ ose si grup, në vartësi të ofendimit në se është bërë e qëllimshme ndaj një individi të vetëm, ose ndaj një grupi shoqëror, në kompleksitetin organik, do të kryhet menjëherë, ose me ndërmjetës.

Artikulli 4.

Ogni volta che i parassiti l’hanno derubata, ogni volta che l’hanno soffocata con la spazzatura, ogni volta che hanno ucciso e derubato le anime dei suoi figli, che hanno fatto strade e città con le sue scaglie, Madre Terra ha preparato il suo veleno. Un po’ alla volta. Trauma dopo trauma. Il dolore delle sue figlie, il disonore dei suoi cicli, del suo corpo, della sua volontà, non l’hanno illusa ma hanno rafforzato il suo veleno. Il diavolo ha dimenticato chi comanda. La malattia all’interno dei loro esseri maledetti non poteva sentire nulla. Non poteva sentire il dolore e le maledizioni di un intero pianeta. Ma iniziò a snocciolare. E questo lo vediamo raffigurato nel libro. “Mentre Ella si lasciava alle spalle gli inferi, l’inferno e il paradiso, quelli che volevano la pace, quelli che desideravano il male, i ricchi e i poveri, i traditori, i fedeli, i dittatori e i democratici, i ladri e gli onesti, i cantanti, i piagnoni, i religiosi e gli atei, i senza voce, gli insistenti, gli ottimisti e i pessimisti, i neri, i bianchi, i rossi e i gialli, gli intelligenti e i muti, i belli e i brutti, ma tutti uguali tra loro” - scrive l’autrice, sottolineando che è la volontà che conta.

Un racconto ha la sua spiegazione. Morale. Canone. Si sono persi? Credo che questo tipo di realtà, la realtà del mondo sotterraneo abbia liberato la sua illusione, e rende l’essenza romanzo, di Angelina Marku.

scrivere su di essa. Un muro rotto, non una reliquia, non un fossile raffinato. Il genere del romanzo è il giallo-horror. Questo è il primo romanzo di Angelina Marku. È nata a Gjakovë, in Kosovo. Ha terminato gli studi presso la scuola pedagogica “Bajram Curri” nella sua città natale. Angelina Marku ha partecipato a numerosi concorsi e ha ricevuto molti premi. Il romanzo porta un nuovo stile epico attraverso i racconti del popolo sotterraneo.

“Dimri i Shekullit” nga Angelina Marku

Nga Ina Gjata - Tirane

“Dashuria për të jetueshmen e të përbashkëtën, duke u mbështetur në humbje dhe duke notuar thellë mes akujve.” Kjo është bota në të cilën hyn Ela, personazhi kryesor me gjyshen. Ajo i tregon mbesës gjysmën e historisë së familjes së saj sepse sëmuret dhe mund të vdesë. Të dyja duhet të marrin rrugën me tren për në spital. Pikërisht ky tren i dërgon në botën e nëndheshme ku fillon një udhëtim mistik. Një rrugë misterioze që nis në një natë shumë të zakonshme Krishtlindjesh.

Pretenca kurrë nuk do arrijë ta dërgojë mortalitetin askund.

Bota e ferrit përbëhet nga kisha dhe xhami, njerëz të lënduar nga e kaluara, engjëj dhe demonë, piramida dhe misticizëm. Njerëz të cilët patën notuar dhe notuar në detet e nëntokës për shekuj me radhë. Një hënë e plotë dhe e përgjakur. Shpirtra në kaos. Shpirtra të cilët e kanë humbur kuptimësinë e asaj që duan. Ata kanë harruar si t’i numërojnë të rënë mes tyre. Nuk u intereson nëse e gjithë bota bie në copa. Kjo është koha për të ndjekur Heroin dhe Elën. Ela është çelësi, ajo duhet të shpëtojë njerëzit nga bota e nëndheshme. Ata duhet të shohin dhe të marrin frymë mes vargjeve të egra dhe qiejve të kuq të të rënëve. Aty ku pushon së lënduari. Aty ku historia fillon të ketë kuptim. Aty ku ata e shohin Heroin si të vetmin Arketip që prevalon. Për të shpëtuar veten nga çmenduria.

Fjalët kanë rënë dhe njerëzit e botës së ferrit nuk janë vetëm impulse. Ato janë kuptimplotë.

Shëtitje të pakuptimita përreth botës së të mallkuarve të mbushura me krijesa rutinore. Kjo nuk është gjithçka që ekziston. Hëna e përgjakur qëndron dhe noton nëpër qiej. Tradhtia nuk mund të jetë kurrë kuptimplotë. Bota e Hadesit, bota e nëndheshme ka instinkt, ka fuqi ka dhe epsh. Dhe shkurret vazhdojnë t’u kujtojnë atyre se kjo nuk është gjithçka që ekziston. Pakuptimësia ecën në të njëjtin cep. Është Ela, gjyshja e saj, Heroi i popullit të saj, Nëna e Paqes, një gazetare, një piktor, Mbretëresha e Besimit dhe Fryma e Shenjtë, e cila shfaqet dhe rishfaqet në formën e një shpendi, dhe njerëz që luftojnë kundër djajve dhe krijesave të botës së ferrit. Heroi i udhëheq ata. Personazhet identifikohen nga profesionet dhe karakteristikat e tyre si njerëz të vdekur që po luftojnë në një botë paralele për të shpëtuar dritën dhe shpirtrat e tyre.

Libri është i ndarë në 3 pjesë:

1. Fillimi; Para se të prezantohet bota e ferrit.

2. Bota e Ferrit; Aty ndodhin pjesa më e madhe e ngjarjeve

3. Fundi; Morali i librit

Në vendin e vdekjes, mbretërit dhe themeluesit e patriarkatit kanë vdekur. Me erën e mungesës dhe të pasigurisë, fushat qajnë. Më parë kishte qenë një dimër i pafund. Plot tradhti dhe verbëri. Kur demonët mërgimtarë themeluan strukturat e tyre dhe u përqopën pafundësisht të torturonin viktimat, ata dinin më shumë për vdekjen dhe më pak për drejtësinë dhe trimërinë e viktimave të vrara antonike. Ata dinin pak për fundin e tyre. Ata dinin pak për fuqitë e tyre të ulëta dhe për fuqinë e vërtetë që nuk do e zotëronin kurrë. Është klithma e Tokës ajo që bashkon fushat dhe pyjet. Është koha. Kur je i pabesë ndaj atyre që të dhanë

frymë, do të shkëputesh prej saj. Ky është morali që marrim nga një udhëtim që duket se nuk mbaron kurrë, pikërisht në tokat e të vdekurve, në librin “Dimri i Shekullit”.

Autorja Angelina Marku na njeh me romanin e saj fantastiko-shkencor, ku kanuni i së mirës dhe dritës fiton dhe i jep rëndësi të vërtetë popullit. Pika kulmore e librit zhvillohet në mbretërit e rënë të patriarkatit që vriten brenda “amfiteatrit” të tyre. Atë që budallallëkun duan ta mbajnë varur, kur tashmë ka vdekur.

Një epokë e re po fillon, por së pari, është e nevojshme t’i jepet fund procesit të patriarkalizmit dhe megjithatë ata vazhdojnë të ecin me shpresën për t’u ngritur. Koha është e ndërlikuar dhe personazhet duhet të luftojnë vazhdimisht për të arritur shpëtimin e shpirtit. Ela dhe gjyshja e saj duhet të arrijnë botën e të gjallëve dhe të kthehen në botën e tyre. Për këtë, ata duhet të luftojnë beteje pas beteje derisa të arrijnë dhe të vrasin udhëheqësin e së keqes, gjysmë njeri gjysmë bishë. Romani “Dimri i Shekullit” më kujton Dan Brown dhe kompletet e tij misterioze, të cilat na mbajnë varur për të lexuar gjithnjë e më shumë.

Është një libër që iu përshtatet atyre që e duan misterin, epikën dhe fantashkencën.

Dashuria është vetë zjarri. Por ndonjëherë do të thotë vdekje. Ndonjëherë është grimca më e madhe e kohës jashtë kufirit të dhimbjes,... dhe ndonjëherë është sulm i një zemërimi të madh, në një skaj të kohës dhe errësirës. Une nuk shkruaj gjithmonë për romane fantastiko-shkencor apo për trupa të vjetër udhëtarësh mes hapësirës dhe kohës por ky është një roman i veçantë, plot jetë në botën e nëndheshme dhe ajo e cila do nënvizojë për lexuesit është morali i librit; Historia e sjellë në roman promovon dashurinë dhe paqen si kanone të jetës njerëzore, në kontrast me vullnetin njerëzor. Të marrësh frymë e të marrësh frymë ashtu siç mallkimet mbushin mishin e djallit... Toka është ende e gjallë dhe po ngrihet. Ne të gjithë e kemi një anë të errët të projektuar në pasqyrën tonë. Mbreti/trimi nuk është subjekt marketimi.

Çfarë do të thotë arketipi i Mbretit në këtë mes?! - Në botën e nëndheshme Mbreti është Heroi, ai është Shpëtimtari, luftëtari, i pari në radhë për të mbrojtur popullin e tij dhe ai që dashuron Elën. Ndërkohë që shfletojmë faqet, Ela dhe Heroi e rrisin dashurinë. Ndoshta kjo është hera e fundit që ata lëndohen, në botën e Hadesit. Ndoshta më në fund ata do të mësojnë të marrin frymë dhe të qëndrojnë së bashku përballë grabitqarit.

Sa herë që parazitët e grabisnin, sa herë që vrisnin dhe rrëmbenin shpirtrat e fëmijëve të saj, bënë rrugë dhe qytete nga drita e saj, Nëna Tokë përgatiste helmin e saj. Pak nga pak. Traumë pas traume. Dhimbja e vajzave të saj, çnderimi i cikleve të saj, i trupit, i vullnetit, nuk e iluzionuan, por ia forcuan helmin. Djalli harroi se kush është në krye. Sëmundja brenda qenieve të tyre të mallkuara nuk mund të ndjente asgjë fare. Nuk mund të ndjente dhimbjen dhe mallkimet e një planeti të tërë. Por ajo filloi të mallkojë. Dhe ne e shohim këtë të përshkruar në libër:

“Pas linte nëntokën, linte ferrin e parajsën, paqedashës, keqdashës, të pasur e të varfër, tradhtarë, besnikë, diktatorë, demokratë, vjedhës e të ndershëm, këngëtarë, vajtores, memecë, oratorë, besimtarë e të pafe, të shurdhër, veshtarë, optimistë e pesimistë, të bardhë e të zi, të verdhë e të kuq, të mençur e budallenj, të bukur e të shëmtuar, por të gjithë të barabartë” - shkruan autorja duke nënvizuar se vullneti është ai që ka rëndësi. Historitë kanë gjithnjë shpjegimin e tyre. Moralin. Tekstin kanonik. A janë personazhet kryesore të humbur në një botë paralele? Besoj se ky lloj realiteti, realiteti i botës së Hadesit e ka braktisur iluzionin, dhe kjo e bën romanin e shkruar nga Angelina Marku, një roman esencial. Zhanri i romanit është horror në një stil të ri epizmi përmes rrugëtimit në botën e nëndheshme.



REFLEKSIONE NGA “DIASPORA 2023”

Nga Petrit R. Aliaj - Brescia

Konferenca e fundvitit “Diaspora 2023”, tashmë, e kthyer në traditë nga Federata e Shoqatave Shqiptare në Itali, mbylli punimet e saj më 17 dhjetor 2023 në Brescia. Emërtimi i konferencave që ka realizuar FNAI përgjatë këtyre viteve pësoi pak ndryshim, duke u pagëzuar me emrin “Diaspora 2021, 2022, 2023...” në librin e regjistrit të Federatës si një zgjedhje e bukur e sekretares, ing. Erida Cela Perlala. Në këtë shkrim do të mundohem të hedh disa të dhëna nga vëzhgimet dhe eksperiencat që kam mundur të përfijtoj si pjesëmarrës i të gjitha asambleve dhe konferencave të Federatës, veprimtari të cilat datojnë që me themelimin e saj më 26.04.2015 në sheshin “Skënderbeu” të provincës Fermo. Në këto veprimtari me karakter atdhetar, aktorët kryesorë janë individë të pasionuar dhe grupe shoqërore, që merren me promovime të krijimtarive të ndryshme si bartëse dhe transmetuese të vlerave nga vendet e tyre të origjinës. Vlera, të cilat krijojnë emocione dhe mbresa në komunitet, për karakterin e tyre bashkues në marrjen e vendimeve kolegjiale në këshillat drejtuese të tyre, duke respektuar e, për rrjedhojë, duke evituar krizat që shkaktojnë kryetarët e përjetshëm. Eca përpara në mënyrën më të thjeshtë të angazhimit vullnetar për të mirën e komunitetit, për të bukurën Arbëri, për të shenjtën gjuhë, është patriotizëm i mbështetur në këto vlera morale, të cilat e bëjnë çdo organizatë të bashkëveprimtimit shoqëror që të afirmohet, të jetë e besuar, të jetë në rolin e një rregullatori bashkërendues në komunitet, për identitet kombëtar dhe për një integrim dinjitos në bashkëjetesë, paqe e harmoni. Krahas të gjitha angazhimeve dhe veçmas për sa i përket anës funksionale, Federata ka ditur të ruajë paprekshmërinë e saj nga influencat partiake, duke zbatuar statutin, pa hezituar për hir të dikujt që kërkon të përfijtojë nga respekti i të tjerëve si edhe nga toleranca e miqësive të sëmurura, ku solidariteti në këto raste thyhet nga konflikti i interesit dhe çon drejt shpërbërjes së saj. Në këto raste realiteti është tregues për të gjitha veprimet dhe mosveprimet nga individë, të cilët kërkojnë të aktivizohen, por që shpejt u bie entuziazmi në ndjekjen dhe zbatimin e detyrave, humbin ndjeshmërinë, kthehen në vëzhgues të papërgjegjshëm e të pavlefshëm në misionin e përbashkët. Për këdo që e ka provuar të jetë në drejtim, krahas gjithë kërkesave dhe detyrimeve, që rrjedhin nga raportet me shoqatat, institucionet dhe organizatat e ndryshme shoqërore në kuadër të bashkëpunimit, paralelisht janë edhe hartimet, miratimet dhe përkujdesi për zbatimin e programeve së bashku me analizat. Pikërisht në vlerësimin e përzgjedhjes së personave intelektualë e aktivë nga stafet drejtuese të shoqatave janë propozimet e tyre në asambletë të zgjedhore, ku një rol të madh ka pasur ardhja në drejtim e intelektualëve të rinj në moshë për efektivitetin e punës së tyre në grup me ndryshime në organizim e metoda pune si p.sh nga ish-presidentet; dr. Anila Cenolli dhe dr. Margita Hoxha. Rëndësi në hartimin e programeve të punës u kushtua edhe daljes nga kornizat standard për çdo fund viti, në atë të një dialogimi të hapur e publik në bashkëpunim me specialistët në drejtim e me konsulentët. Gjithçka e gjykuar për anën funksionale të çdo konference është konsideruar një shtytë “e imponuar”, e mirëorganizuar për të gjetur temat që prekin shqetësimet e diasporës, mënyrën e komunikimit direkt, takimet online, kontaktet e shumta individuale me angazhimin e të gjithë stafit drejtues me shoqatat aderuese, të cilat janë motorët që e bëjnë të funksionojë mirë atë të organizimit, shtrirjes, zgjerimit dhe përfshirjes e kategorive të shumta në veprimtari të përbashkëta. Puna ngulmuese për të kërkuar bashkërendime me shoqata të tjera, larg egos për të qenë gjithmonë në krye ose për të diktuar, është konkretizuar me thirrje të hapura publike për bashkëpunim dhe aderim në Federatë. “Të gjitha këto elemente bashkëpunimi në përfshirje, krijojnë mundësi të shumta për të realizuar e zgjidhur një gamë veprimtarish shoqërore dhe mjaft probleme të tjera jetike që hasen në Itali, ndryshe nga vendet e tjera të Bashkimit Europian, ku vërehet më shumë tendenca për urrejtje, racizëm dhe ksenofobi”. (Amnesty International Italia), na diktojnë zgjidhjet e tyre në unitet dhe të lidhur pandashmërisht me shtetet tona amë ku, ndër kryesoret është çështja e ruajtjes së gjuhës dhe traditave kombëtare në gjurin e shoqërisë multietnike italiane, si një forcë dhe energji e fuqishme asimiluese. Kombet e tjera e kanë zgjidhur çështjen e ruajtjes së identitetit, duke ngritur një sistem të tërë, me shtëpi kulturore, librari, teatër etnikë, biblioteka, institute të kulturës etj., të cilat i mungojnë komunitetit shqiptar, edhe pse ka veprimtarë, të cilët kanë bërë dhe bëjnë përpjekje të lavdërueshme për ruajtjen e identitetit me mundësi të pakta, vullneta-

risht dhe pa asnjë mbështetje financiare nga shtetet tona, qoftë kjo edhe për të mbështetur një konferencë, dy, tre, katër që ka projektuar dhe realizuar Federata Kombëtare e Shoqatave Shqiptare në Itali. Kjo është një veprimtari me përmasa mbarëkombëtare, me cilësi, rrjedhshëm, bukur edhe pse në vështirësi për të paguar sallat, mjetet, kuadrin e duhur, të menduarit racional në kohë për sistemimin dhe spostimin e të gjithë atyre që ftohen për të marrë pjesë në tubimet e konferencave në vazhdimësi. Kurorëzimi me sukses i Konferencës “Diaspora 2023” është në nde-



rin e të gjithë atyre që kontribuan për ta realizuar atë, duke filluar me plan-programin e Këshillit Drejtues të Federatës, ngritjen e grupit të punës për drejtimin e saj dhe krejt ekipin e Drekës Festive të sinkronizuar mirë nga z.Ndue Shabaku (Zëdhënës i Federatës). Merita e oratorëve në tërësinë e problemeve që u trajtuan, qëndron në faktin se ata jetojnë të përditësuar me çka duhet dhe bëhet për emigracionin, vlera të cilat diktuan përzgjedhjen dhe përfshirjen e tyre në Konferencë, duke e bërë atë cilësore në pjesëmarrje dhe sensibilizuese, për çka përjetojmë e çka duhet të bëjmë së bashku për diasporën në Itali. Më vjen mirë të ndaj përgëzimet e mia për mbarëvajtjen e punimeve të Konferencës për drejtuesin e saj dr. Adela Shehu si intelektuale me shumë eksperiencë në promovimin e vlerave kombëtare e të trashëgimisë sonë gjuhësore e kulturore në bashkëpunim edhe me shoqata të tjera simotra të komunitetit shqiptar në Sloveni e Kroaci, me historianë, shkrimtarë, përkthyes e albanologë në Trieste.

Në konferencë ishin ftuar edhe disa shoqata me shqiptarë nga Kosova nga të cilët nuk mori pjesë asnjë përfaqësues i tyre, asnjë mesazh përgëzues, asnjë reagim për konferencën. Aty u fol edhe për situatën e rënduar në veri të Kosovës për atdheun e tyre, pasi fakti që lobi serb është i mirëorganizuar, i paguar dhe në unitet e i sinkronizuar me ata që llojnë edhe brenda BE, me qeverinë e tyre ultra nacionaliste, jo vetëm që nuk e njeh pavarësinë e saj, por po provokon hapur me trupa ushtarake, duke krijuar një situatë shpërthyes për një kthim mbrapa. Furia antishqiptare kundër shtetit të Kosovës kërkon unitet, bashkëpunim dhe bashkërendim edhe të mërgatës ku në këto shoqata ka edhe ish-luftëtarë të UÇK, kontribues të 3% për luftën çlirimtare, të cilët janë betuar në gjuhë përpara flamurit kombëtar me fjalët: “Unë, ushtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, betohem se do të luftoj për çlirimin e tokave shqiptare dhe bashkimin e tyre...” Ndofta konstatimi im mund të jetë i gabuar, por ndihem keq kur disa prej këtyre shoqatave u mungon dëshira për bashkëpunim në planin kombëtar, si një e keqe e madhe e cila do ta mbajë për shumë vite Kosovën dhe Shqipërinë të ndarë, dhe mos o zot, ndaj do të bëhet e pa mundur edhe ruajtja e sovranitetit të saj territorial.

Për dr. Enisa Gordani shpreh konsideratat e mia për bashkëpunimin e saj brilant, duke treguar respekt për mundësinë dhe besimin që i afrova për trajtimin e temës; “Emigracioni dhe emancipimi, roli i gruas shqiptare” për të cilën edhe nga publiku në rrjetet sociale ka marrë përgëzime dhe urime së bashku me duartrokitjet tona në sallë, trajtimin, rolin dhe vendin që duhet të zërë gruaja shqiptare në shoqëri, për forcën dhe dinjitetin e saj njerëzor si krijuese e jetës. Faleminderit dr. Enisa! - “Petrit! Kur të vini në Asti, merrni me vete qeleshe, lodra e daulle, flamuj e banderola, gajde, çifteli dhe po të keni kostume kombëtare, i vishni ato” - ishte mesazhi i drejtorit të Qendrës Kulturore “Margarita Xhepa” në Asti, prof. Hasan Bulçari për pjesëmarrje në paradën shumëngjyrëshe kombëtare më 23 shtator 2023.

Faleminderit miku ynë Hasan Bulçari edhe për mesazhin e drejtuar të gjitha shoqatave për bashkërendim të aktiviteteve rreth një familjeje të madhe me FNAI-n.

(vijon në faqen 22)

RIFLESSIONI DALLA “DIASPORA 2023”

La conferenza di fine anno “Diaspora 2023”, ormai diventata una tradizione della Federazione delle Associazioni Albanesi in Italia, ha concluso i suoi lavori il 17 dicembre 2023 a Brescia. La denominazione delle conferenze organizzate dalla FNAI negli anni ha subito una piccola modifica, venendo ribattezzate “Diaspora 2021, 2022, 2023...” nel libro dei registri della Federazione, come una scelta piacevole della Segretaria, Ing. Erida Cela Perlala. In questo articolo, cercherò di fornire alcuni dati dalle osservazioni e dall'esperienza che sono stato in

grado di acquisire come partecipante a tutte le assemblee e conferenze della Federazione, eventi che risalgono alla sua fondazione il 26 aprile 2015 nella piazza “Skënderbeu” della provincia di Fermo. In queste attività dal carattere patriottico, i protagonisti principali sono individui appassionati e gruppi sociali che si occupano

di promuovere varie creazioni come portatori e trasmettitori di valori dai loro paesi di origine. Valori che creano emozioni e impressioni nella comunità, per il loro carattere unificante nella presa di decisioni collegiali nei loro consigli direttivi, rispettando e, di conseguenza, evitando le crisi causate dai presidenti perenni. Andare avanti nel modo più semplice di impegno volontario per il bene della comunità, per la bella Arbëria, per la sacra lingua, è patriottismo sostenuto da questi valori morali che rendono ogni organizzazione di cooperazione sociale affermata, affidabile, nel ruolo di un regolatore coordinatore nella comunità, per l'identità nazionale e per un'integrazione dignitosa nella coesistenza, pace e armonia. Oltre a tutti gli impegni e in particolare per quanto riguarda l'aspetto funzionale, la Federazione ha saputo mantenere la sua inviolabilità dalle influenze partitiche attuando lo statuto, senza esitare per il bene di qualcuno che cerca di trarre vantaggio dal rispetto degli altri e dalla tolleranza di amicizie malsane, dove la solidarietà in questi casi è spezzata dal conflitto di interessi e porta alla sua dissoluzione. In questi casi, la realtà è indicativa di tutte le azioni e inazioni di individui che cercano di attivarsi, ma il cui entusiasmo cala rapidamente nel seguire e attuare i compiti, perdendo la sensibilità, diventando osservatori irresponsabili e inutili nella missione comune. Per chiunque abbia provato a essere alla guida, oltre a tutte le richieste e obblighi che derivano dai rapporti con le associazioni, istituzioni e diverse organizzazioni sociali nel quadro della cooperazione, ci sono anche la stesura, l'approvazione e la cura nell'attuazione dei programmi insieme alle analisi. Proprio nella valutazione della selezione di persone intellettuali e attive dai team direttivi delle associazioni ci sono le loro proposte nelle assemblee elettorali, dove un grande ruolo è stato giocato dall'arrivo alla guida di giovani intellettuali per l'efficacia del loro lavoro di gruppo con cambiamenti nell'organizzazione e nei metodi di lavoro come ad esempio dagli ex presidenti; Dr.ssa. Anila Cenolli e Dr.ssa. Margita Hoxha. Importanza nella stesura dei programmi di lavoro è stata data anche all'uscita dagli schemi standard per ogni fine anno, in quello di un dialogo aperto e pubblico in collaborazione con specialisti nella guida e con consulenti. Tutto ciò che è stato valutato per l'aspetto funzionale di ogni conferenza è stato considerato uno stimolo “imposto”, ben organizzato per trovare argomenti che toccano le preoccupazioni della Diaspora, il modo di comunicare direttamente, gli incontri online, i numerosi contatti individuali con l'impegno di tutto lo staff direttivo con le associazioni aderenti, che sono i motori che la fanno funzionare bene nell'organizzazione, estensione, espansione e coinvolgimento di molte categorie in attività congiunte. L'insistenza nel cercare coordinamenti con altre associazioni, lontano dall'ego di essere sempre al comando o di dettare, si è concretizzata con richieste pubbliche aperte per la cooperazione e l'adesione alla Federazione. “Tutti questi elementi di cooperazione nell'inclusione, creano molte opportunità per realizzare e risolvere una gamma di attività sociali e molti altri problemi vitali che si incontrano in Italia, diversamente dagli altri paesi dell'Unione Europea dove si nota più tendenza

all'odio, al razzismo e alla xenofobia”, (Amnesty International Italia), ci dicono le loro soluzioni in unità e legate indissolubilmente ai nostri paesi madre dove, tra le principali, c'è la questione della conservazione della lingua e delle tradizioni nazionali nel grembo della società multietnica Italiana, come una forza e un'energia assimilativa potente. Altre nazioni hanno risolto la questione della conservazione dell'identità istituendo un intero sistema, con case della cultura, librerie, teatri etnici, biblioteche, istituti di cultura ecc., che mancano alla comunità Albanese, anche se ci sono attivisti che hanno fatto e stanno facendo sforzi lodevoli per conservare l'identità con poche possibilità, volontariamente e senza alcun supporto finanziario dai nostri stati, anche solo per sostenere una, due, tre, quattro conferenze progettate e realizzate dalla Federazione Nazionale delle Associazioni Albanesi in Italia. Questa è un'attività con dimensioni nazionali, con qualità, fluidità, bellezza anche se in difficoltà a pagare le sale, i mezzi, il personale adeguato, il pensiero razionale in tempo per l'allestimento e lo spostamento di tutti coloro che sono invitati a partecipare alle riunioni e conferenze continue. Il successo della Conferenza “Diaspora 2023” è un onore per tutti coloro che hanno contribuito a realizzarla, a partire dal piano-programma del Consiglio Direttivo della Federazione, dalla creazione del gruppo di lavoro per la sua direzione e da tutto il team del Pranzo Festivo ben sincronizzato dal Signor Ndue Shabaku (Portavoce della Federazione). Il merito degli oratori nell'intero trattamento dei problemi trattati risiede nel fatto che vivono aggiornati su cosa si deve e si fa per l'emigrazione, valori che hanno dettato la loro selezione e inclusione nella Conferenza, rendendola qualitativa nella partecipazione e sensibilizzante, per quello che viviamo e cosa dobbiamo fare insieme per la Diaspora in Italia. Sono felice di condividere le mie congratulazioni per il buon svolgimento dei lavori della Conferenza alla sua direttrice Dr.ssa. Adela Shehu come intellettuale con molta esperienza nella promozione dei valori nazionali e del nostro patrimonio linguistico e culturale in collaborazione anche con altre associazioni sorelle della comunità Albanese in Slovenia e Croazia, con storici, scrittori, traduttori e albanologi a Trieste.

Alla conferenza sono state invitate anche alcune associazioni con albanesi del Kosovo, delle quali nessun rappresentante ha partecipato, nessun messaggio di congratulazioni, nessuna reazione alla conferenza. Si è parlato anche della situazione aggravata nel nord del Kosovo per il loro paese natale, poiché il fatto che il lobbismo serbo sia ben organizzato, pagato e in unità e sincronizzato con quelli che fanno lobbismo anche all'interno dell'UE, con il loro governo ultra nazionalista, non solo non riconosce la sua indipendenza ma provoca apertamente con truppe militari creando una situazione esplosiva per un ritorno indietro. La furia antiAlbanese contro lo stato del Kosovo richiede unità, cooperazione e coordinamento anche della Diaspora dove in queste associazioni ci sono anche ex combattenti dell'UCK, contributori del 3% per la guerra di liberazione, che hanno giurato in ginocchio davanti alla bandiera nazionale con le parole: “Io, soldato dell'Esercito di Liberazione del Kosovo, giuro di combattere per la liberazione delle terre albanesi e per la loro unificazione...” Forse la mia affermazione potrebbe essere sbagliata, mi sento male quando alcune di queste associazioni mancano di desiderio di cooperare a livello nazionale, come un grande male che manterrà il Kosovo e l'Albania separati per molti anni, e, Dio non voglia, renderà anche impossibile la conservazione della sua sovranità territoriale.

Per la Dr.ssa. Enisa Gordani esprimo le mie considerazioni per la sua brillante cooperazione mostrando rispetto per l'opportunità e la fiducia che le è stata data per trattare il tema; “Emigrazione ed emancipazione, il ruolo della donna Albanese” per il quale anche il pubblico sui social network ha ricevuto congratulazioni e auguri insieme ai nostri applausi in sala, trattamento, ruolo e posto che la donna Albanese dovrebbe occupare nella società, per la sua forza e dignità umana come creatrice della vita. Grazie Dr.ssa Enisa! “Petrit! Quando vieni ad Asti, porta con te cappelli, giocattoli e tamburi, bandiere e striscioni, cornamuse, “çifteli” e, se hai costumi nazionali, indossali” - era il messaggio del direttore del Centro Culturale “Margarita Xhepa” ad Asti, Prof. Hasan Bulçari per la partecipazione alla parata nazionale multicolore il 23 settembre 2023.

Grazie al nostro amico Hasan Bulçari anche per il messaggio indirizzato a tutte le associazioni per il coordinamento delle attività attorno a una grande famiglia con FNAI.

(continua al pagina 23)

Talentet nga diaspora në futboll

Nga Namik Mehmeti -Firenze

Nga data 4-7 dhjetor, në ambientet e “Shtëpisë së Futbollit” në Tiranë, FSHF organizon një seleksionim të talenteve të futbollit për moshat e datëlindjeve 2006-2007 dhe 2008-2009, për të përzgjedhur talentet, që do të përfshihen në kombëtaret respektive. Në këtë monitorim e seleksionim të organizuar nga FSHF, tranierët e ekipeve kombëtare, në praninë e Drejtorit Teknik pranë FSHF, Flaviu Pea kishin fuar dhjetra futbollistë nga Europa, SHBA, Azia etj, të cilët ëndërrojnë të veshin fanelën kuq e zi. Në mes tyre ishin dhe dy futbollistët 17 vjecarë që luajnë në ekipet e moshave në kampionatin e Toskanës, Gerard Mirashi dhe Veis Shenaj. Pas kthimit nga Tirana me dy talentet shqiptarë të lindur në Itali zhvilluam këtë intervistë.

Sigurisht që ishit në pritje të kësaj ftese nga FSHF, një ftesë e tillë nuk është pak për një të ri që ëndërron të bëjë karrierë në futboll?

Gerard Mirashi: Nuk i fshih emocionet, padyshim që ishte realizimi i një ëndre që e kam përjetuar me shumë emocion, pasi të veshësh një ditë fanelën kuq e zi kërkon përkushtim në stërvitje dhe në ndeshjet që zhvilloj me skuadrën “Catolica Virtus” këtu në Firenzë. Kjo ftesë ishte edhe një vlerësim për klubin ku unë luaj, klub ky që i ka dhuruar kombëtares italiane emra të mëdhenj si P. Rosi apo Barzagli.

Veis Shenaj: E kam pritur se një ditë kjo ftesë në adresën time nuk do të mungonte. As që nuk diskutohen emocionet që përjetova, por ftesa më dha optimizëm. Kjo ftesë vlerëson edhe punën që bëjnë tranierët e mi në ekipin ku unë luaj “ASD San Giovannese” në S. G. Valdrano.

Njohja me ambientet “Shtëpisë së Futbollit” ju ofroi ngrohtësi, pasi është shtëpia e juaj si shqiptarë, kjo ndoshta dhe për të gjithë të ftuarit?

G. Mirashi: Ambientet ishin fantastike dhe të gjithë të ftuarit që kishin ardhur nga cdo skaj i botës u ambientuan menjëherë. Me mikpritjen e organizatorëve do ta ndjenim veten si në shtëpinë tonë, pa harruar edhe organizimin e përsosur që u bë.

V. Shenaj: Ashtu është, njohja me bashkëmohatarët tanë që vinin më shumë nga Europa, në këtë provë, u bë edhe më simbolike. Këtë që afruan ambientet e “Shtëpisë së Futbollit” ishin fanatistike si në Europë.

Kur vihesh në një provë të tillë edhe fansat që ju ndjekin në Firenzë ju mungonin. A ndikoi ky fakt në prezantimin e performancës tuaj?

G. Mirashi: Prania e shumë spektatorëve që na ndiqnin më dha një impuls që të demonstroja performancën time, bile të kisha edhe ambicje për ta justifikuar ftesën.

V. Shenaj: Pra sic theksova edhe më parë, ne gjetëm frymëzim për një konkurim dinjitoz cka do ta tregonim me shpirt gare në stërvitje dhe në ndeshjet që zhvilluam.

Edhe stafi teknik që ju u ballafaquat ishte i panjohur. Cila është përshkrimi juaj për atë çka ju afrua nga stërvitja dhe në ndeshjet që zhvilluat?

G. Mirashi: Ajo që më bëri më shumë përshtypje ishte fakti



që stafi teknik na trajtoi pa bërë diferencime dhe cdo gjë që na ofroi ishte në përputhje me përgatitjen tonë fizike e teknike. Patëm biseda të singerta dhe ata ishin të interesuar edhe për pozicionet që ne kemi në ekipet ku luajmë në kampionatin e Toskanës.

V. Shenaj: Stafi, që për dy ditë punoi me ne ishte mjaft profesionist. Komunikuam pa ndrojtje dhe jemi të bindur se vlerësimet e tyre do të jenë objektive.

Gjatë zhvillimit të ndeshjeve të kontrollit ju u pozicionuat në role që jeni përshtatur këtu në ekipet ku përgatiteni e luani në Firenzë?

G. Mirashi: Së pari stafi teknik i FSHF na e kërkoi një gjë të tillë dhe ne u treguam tranierëve se në çfarë rolesh luanim në ekipet tona. Unë në dy ndeshje prove u rjeshtova në pozicionin tim të preferuar atë të qendërmbrojtësit, detyrë që me bindjen time e realizova me mjaft siguri.

V. Shenaj: Unë u aktivizova po në atë rol që luaj në ekipin tim, pra atë të mesfushorit. Në ndeshjen e parë u vura në provë në pozicionin e krahut të majtë, ndërsa në ndeshjen e dytë në atë të mesfushorit, detyra që i përmbusha me kënaqësi dhe me një angazhim total.

Së fundi mbas dy ditëve që ju kanë lënë mbresa u larguat nga Tirana me shpresën se një tjetër ftesë mund të jetë realitet, pra përfshirja në gjirin e kombëtares së 17 vjecarëve?

G. Mirashi: U larguam nga Tirana me mbresat më të mira dhe mbetëm në pritje të realizimit të dëshirës time për të veshur fanelën kuq e zi, një ambicje kjo që merr frymëzim edhe nga kualifikimi i kombëtares tonë në finalët e Kampionatit European, Gjermani 2024. Me këtë rast i uroj tranierit Silvinjo, stafit të tij dhe ekipit kombëtar suksese në këtë ballafaqim të mirëpritur nga shqiptarët kudo ku janë anëmbanë botës.

V. Shenaj: Edhe unë si Geri falënderoj FSHF për ftesën që na bëri dhe na hapi rrugën për të shpresuar se do të realizojmë ëndrrën tonë për të luajtur për kombëtaren e vendit të lindjes së prindërve tanë, aq më tepër kjo ëndërr merr rrugë kur ndihemi krenarë për përfaqësimin e Shqipërisë në finalët e Kampionatit European, Gjermani 2024. Urime për këtë arritje që ka bërë jehonë edhe këtu tek ne në Itali.

Këto ishin mbresat e dy talenteve të futbollit Gerard Mirashi dhe Veis Shenaj për moshat 17 vjecare, që luajnë në kampionatin rajonal të Toskanës, të cilët janë zgjedhur më shumë se një herë në “Top 11” të javës.

Riflessioni dalla “Diaspora 2023”

(continua dal pagina 19)

Ha fatto la radiografia del lavoro e dei sacrifici della comunità Albanese ad Asti, per i loro contributi in valuta per la costruzione e il funzionamento di questo meraviglioso centro culturale, che ho avuto la fortuna di visitare con i dirigenti dell'associazione “Alba” a Brescia dove siamo stati accompagnati dal Signor Nikolin Gjeloshi, “Ambasciatore della Nazione” e ideatore di questo centro.

- “Sono questi patrioti albanesi che hanno donato i fondi, hanno lavorato e lo hanno messo a disposizione della comunità Albanese e locale questo centro, in cui danno il loro contributo specialisti dell'arte, della cultura, della lingua, collaboratori, genitori con bambini e insegnanti, ecc.” - ha spiegato il nostro amico Nikolin mostrandoci l'elenco dei nomi dei contributtori esposti all'interno del centro culturale. Nel suo modesto saluto alla conferenza, il Signor Nikolin Gjeloshi, tra le altre cose, ha proposto che il Vertice della Diaspora dovrebbe essere organizzato da noi.” Con grande considerazione estendo i miei complimenti e ringraziamenti al presidente dell'associazione “AssoAlbania” ad Asti, il Signor Marjan Bjeshkzaper la sua collaborazione, le sue considerazioni sul lavoro collettivo della Federazione e la partecipazione a entrambe le conferenze tenute, aggiungendo anche la proposta di realizzare la conferenza “Diaspora 2024” ad Asti. “Per l'impegno sociale che il Signor Granit Muçaj ha assunto insieme ai membri del Consiglio Direttivo della Federazione, colgo l'occasione per congratularmi con lui per la sua posizione e le determinazioni riguardo al ruolo che la Federazione Nazionale e tutti coloro che parlano Albanese dovrebbero giocare, indipendentemente dal cosmopolitismo linguistico nelle nostre relazioni, dove il fenomeno dell'indifferenza estrema è semplicemente un colpo fatale contro le idee e le iniziative intraprese, facendo vacillare anche i sentimenti più entusiasti del gruppo.

Questo è stato uno dei tanti argomenti e preoccupazioni che ci ha trasmesso nel suo rapporto il Presidente della Federazione, il Signor Granit Muçaj, come un fenomeno che diventa educazione e si trasforma in cultura burocratica e istituzionale. In fin dei conti, tutto ciò che viene realizzato nella Diaspora dai migranti, sono valori che trasmettono, ma non riescono a raggiungere dove dovrebbero o ad avere vicino a loro coloro che sono necessari. Ricordo una conversazione con un leader della comunità marocchina a Brescia, che mi ha spiegato che il loro Ministro degli Esteri viene una volta ogni due mesi e tiene un incontro aperto con i rappresentanti della loro comunità nella regione della Lombardia, per ascoltarli e poi incontra i principali rappresentanti dello stato Italiano, per aggiornarli sui problemi che incontrano. -Tra l'altro, quando parliamo anche in termini di cooperazione, ci avviciniamo a molti intellettuali come professori, medici, dottori, avvocati, scrittori, creatori e leader di attività economiche che meritano i loro nomi per quello che fanno ecc. Mentre abbiamo anche un'altra categoria in cerca di gloria, onorari e compostità che insistono per salutare dai palchi. È come fare l'amore condizionatamente con alcuni tipi senza scrupoli, vanitosi e senza personalità che ci dicono: “Sì, sì, sarò lì, ma voglio parlare per tanti minuti”. Sono tipi che cercano sempre di parlare del “Belulo”(egocentrica) e diventano un ostacolo e un problema per ogni iniziativa con la loro energia negativa di vanteria. In considerazione di tutti gli incontri, conferenze e impegni congiunti delle associazioni della Federazione FNAi, apprezzo tutti i leader delle altre associazioni che ci hanno onorato con la loro partecipazione e i loro valori, esprimendo anche il desiderio di cooperare in coordinamento con la Federazione. FNAI. Rispetto e riconoscimento per i loro leader: Marjan Bjeshkëza “AssoAlbania”, Asti; Ndrim Kercuku, “Krenaria Shqiptare”, Pordenone; Silvana Muço Dogani, “Radici & Ali”, Pescara; Sonila Otobashi, “Skanderbeg”, Parma; Eno Dule,

“Ura”, Novara; Petrit Gjinaj, “Ura e Bashkimit”, Ponte di Legno; Mahije Bujupi Berisha, “Lidhja e Mësuesve Shqiptarë”; Elvira Lashi “Forum Donna Indipendente”, ecc. Spero che si svegli la categoria di persone che hanno osservato la Federazione Nazionale fin dalla sua fondazione con scetticismo e arroganza, disprezzo e in coro con frasi del tipo “Oh, ci siamo divertiti”, ignorando la sua esistenza, attività, trasparenza, richieste crescenti di lavoro e cooperazione aperta e sempre in difesa degli interessi della comunità Albanese in Italia e all'estero, per un'integrazione dignitosa e una convivenza con il popolo Italiano, che ci ha aperto le porte dell'amicizia. -Dalla Grecia ha salutato anche la conferenza il Signor Ardian Daullja, Presidente dell'Unione delle Associazioni Albanesi in Grecia che ha augurato agli organizzatori e ai presenti la continuità di queste conferenze molto necessarie per tutti gli albanesi ovunque si trovino. In questa occasione ha dichiarato e ringraziato per le iniziative di cooperazione bilaterale tra l'Unione che dirige e la federazione FNAi nella promozione dell'arte, della cultura, delle tradizioni, della conservazione e dello sviluppo della lingua Albanese, nonché la promozione e l'iniziativa di esercitare i diritti sociali della comunità Albanese in Grecia e in Italia. La nomina del Dottor Dava Gjoka alla guida della commissione bilaterale di cooperazione tra l'USHSHG e la FNAI porterà esperienze con incontri e visite reciproche, decisioni su azioni congiunte e l'istituzionalizzazione delle nostre relazioni nei rapporti con gli stati in cui viviamo e anche con quelli di origine a favore della comunità Albanese in entrambi i paesi. Per il costante sostegno alla realizzazione della Conferenza e per la partecipazione ringrazio in particolare il Console Generale della Repubblica del Kosovo a Milano, il Signor Diamant Kastrati, la Console Generale della Repubblica d'Albania a Milano, la Signora Anila Pojani per il suo saluto alla Conferenza e il Dottor Vat Marashi per il suo sostegno finanziario. Ci vediamo alla “Diaspora 2024”.

(Traduzione Anisa Karagozi)

WINGS TRAVEL & Cargo



TRANSPORT NDERKOMBETAR Udhëtarë & Mallra
Bari, Foggia, Pescara, Ancona, Rimini, Bologna, Modenam, Parma, Piacenza, Milano, Bergamo, Brescia, Cremona

Autobus	+39 331 160 4572	Kamion	+39 324 551 7365
	+39 328 316 8617		+39 327 426 6040
	+39 327 426 6040		+355 69 337 3797
Shoferi	+355 68 545 0000	Makina me qera	+355 69 337 3797

WINGS TRAVEL
Shqipëri - Itali - Shqipëri



WINGS TRAVEL

Bileta Avioni
Bileta Trageti
Bileta Autobuzi
Siguracione
Makina me qera

+355 69 337 3797
+355 68 840 8000
+39 331 1604572
+39 327 4266040
+39 328 316 8617

wingsagency@yahoo.com

Është për t'u lavdëruar gjesti bujar i shoferit të Kompanisë "Wings Travel & Cargo" Z. Hasan Nezaj, me origjinë nga Tropoja dhe banues në Durrës, i cili prej shumë kohësh nga Shqipëria për në Itali është një ndër shpërndarësit kryesor të gazetës "Rrënjët". Kur e pyet përse vallë gjithë ky përkushtim, me thjeshtësi të përgjigjet: "Ndjem krenar që kjo gazetë me frymë kombëtare e me emrin kuptimplotë "Rrënjët" të ndodhet në çdo familje shqiptare në mërgim.



BONI TRAVEL

SHQIPERI - ITALI - SHQIPERI

Administrator: Bilbil Çobaj
Shoferat

+355 692178389 +39 3444181239
+355 695222784 +39 3497447196

Adresa: VLORE - ALBANIA

Shoferit zemërbujar e patriot Bilibil Çobaj sapo i njoftuam mbi shpërndarjen e gazetës "Rrënjët" me thjeshtësi e buzëgaz na tha: "Është një nder e krenari për Kompaninë "Boni Travel" si dhe për mua personalisht që gazeta mbarëshqiptare të ndodhet në autobuzat e linjës: Arezzo, Bari, Brindisi, Firenze, Genova, Napoli, Pisa, Prato, Roma e Savona." Ai na premtoi që tashmë kjo gazetë me emrin kuptimplotë "Rrënjët" do të ndodhet kudo ku shkon "Boni Travel".

NOI srl
materiale edile

Shytermeja Aurel | Cell. 345 3029764
noi2017srl@libero.it

NOI s.r.l. - Via Anna Maria Mozzoni, 30
06073 Corciano, Perugia - Tel. 075 6979540 - P. IVA 03552250544

Nel punto di vendita NOI srl a Perugia, troverete un servizio professionale, speciale e tutti i materiali che cercate ..., ma di più troverete anche il nostro giornale "Le Radici". Il titolare, Shytermeja Aurel, è una persona eccellente che vi aspetta a braccia aperte.



Tek Smerald Shpk Vlore me President Mihal Selimaj do të gjeni llojshmëri materiale si: Pllaka të dimensioneve të ndryshme, paisje Hidrosanitare, Aksesorë, Tulla për Oxhak, Mozaik shumëngjyresh, Kol, Fino, Stuko..., por mbi të gjitha një shërbim të shpejtë, cilësor e me kulturë. Ju mirëpresim në ambjentet tona me shumëllojshmëri materiale sipas gustos dhe shijes suaj dhe me çmim të arsyeshëm.

Smerald Shpk Vlore

Adresa: Rruga Trasballkanike, pranë rrethrotullimit të Omones.
Magazina qendrore në hyrje të Nartës.
Vlorë, Albania Tel: 00355/67202359 & 00355/682040290
FB : Smerald Shpk Vlore